



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 151, MAJ 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Ndërroi jetë inzot Luciano Avgustini, ipeshkvi i Dioqezës së Sapës



10 VJET SHOQATA "ATDHETARE DUKAGJINI", DEGA TIRANË

Me datën 30 prill 2016, ne mjediset e Muzeut Kombëtar, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Dega Tirane, organizoj një veprimtari promovuese të botimit të librit "10 vjet Shoqata "Atdhetare Dukagjini", Dega Tiranë, botim i pergatitur nga Zef Gjeta dhe Zef Bari.

Morën pjese antare të shoqates dhe miq e të ftuar. Veprimtaria u mbeshet nga anëtarë themelues i deges Tirane, ing. Gjergj Voci. Veprimtaria u mbyll me një koktej.

AGUSTIN KOLA, DINAMIKU DUKAGJINAS I TIRANËS

Agustin Pjetër Kola ka lindur më 10 maj 1959 ne Tirane dhe ka qenë një futbollist me shkëlqyer skuadrës dominuse te kapinatit shqiptare te futbollit SK Tirana (17 Nëntori i atehershëm) dhe ka udhëhequr drejt majave me te larta te futbollit shqiptar te femije kur ai filloi në ekipin e notit që stërvitej tek Liqeni Armatial.

Gjurash - Černojeviçët dhe vijimësia e pranisë shqiptare në Malin e Zi

Nikollë Loka / Shtrirja e shtetit serb të Stefan Nemanjës në teritorët që sot përbëjnë Malin e Zi, në çerekun e fundit të shek. XII, solli aty elementë sllavë, që erdhën dhe iu shtuan grupeve të tjera sllave të kohëve të kolonizimit të parë të shekujve VI-VII. Në Diokle, krahas popullsisë shqiptare edhe atyre sllave, në disa nga qytetet e bregdetit mbijetuan dhe grupe të vogla të banorëve të ro...

Mendime për fenomenin e gjakmarrjes

U bën rreth 26 vite që e ecim e ecim duke u marre me fenomenin e gjakmarrjes shume shoqata, fondacione e deri struktura të shtetit Shqiptare, që u i ringjall pas vitit 1990. Në këto vite, kemi lexuar e dëgjuar shume ndodhi, shume shifra, janë bere shume takime, deri dhe ish një President e Republikës së Shqipërisë, i cili ndjen kënaqësi kur mori pjese në pajtimin e dy familjeve, që njëra familje fali gjakun familjes tjetër, deri sa Ministri Arsimit që trishtohet shume kur në prehër i vunë vajzën e ngujuar, deri sa edhe një vajze i mësojnë një poezi gjakmarrjen dhe e detyrojnë ta recitojë në çdo takim, në çdo veprimtari e deri në TV "Top Channel" ...

MARTIN CAMAJ, SHKRIMTARI I LARTËSIVË

Nga Ismail Kadare

Ndjesia e parë që provon lexuesi kur hyn në botën letrare të Martin Camajt është ajo e lartësisë. Pa përjashtuar përfitimin eufemik të shprehjes, atë që ka lidhje me gjithë shkrimtarët e mëdhenj të një letërsie, te Camaj shprehja merr një kuptim të mirëfilltë. Në shumicën e veprave të tij, në mjediset e përshkruara, në klimën e tyre, te personazhet, ajri, madje dehjet e shëndetshme apo të turbullta që vijnë prej tij, janë ato të alpeve. Sipas Ernest Koliqit, adhures e njëherësh mentor i shkrimtarit, ky luks gjeografik lidhet me zanafillën e shkrimtarit. Lartësitë e bjeshkëve, më saktë Dukagjini, ai kishte lindur, kishin gjetur, më në fund, te biri i ty...



NË TRADITË KULTURORE

Reportazh nga Manifestimi "Zëri i Vëllazërisë 2016"

Në vazhdim të traditës disavjeçare që kemi krijuar me datën 28, 29, 30 prill u zhvillua veprimtaria, Manifestimi "Zëri i Vëllazërim-it-2016", që ne ishim pjese e tij. Në baze të programit të miratuar nga grupi organizator i të gjitha shoqatave pjesëmarrëse, me datën 28 prill, Manifestimi filloi në qytetin e Shkodrës. Miqtë nga Peja, u priten në ora 11. 30, te monumenti Isa Boletinit. Në takim ishte Gjergj Leqeja, Luigj Shyti, Prele Shytani, Roza Pjetri, Zef e Xhovana Sokoli. Ata ishin Ukshin Jashari, Frashër Racaj, Vesel Nikçi, e të tjerë të gjithë së bashku bëmë homazhe në monumentin e Isa Boletinit. Pastaj shkuam te monumenti i Mehmet Shpendit, Luigj Gurakuqit e Nene Terezës, ku u vendosën kurora me lule dhe u bënë fotografi. Në orën 13. 00 bëmë takim me Kryetaren e Këshillit të Qarkut Shkodër, zonjën Greta Bardel...

KUJTESË

Të dashur bashkëpunëtorë!

Redaksia e gazetës "Dukagjini" ndjehet mirë me bashkëpunimin tuaj, për të cilin ju falënderojmë dhe ju mirëpresim edhe në vazhdim në gazetën tonë. Redaksia ju kujton se, ruan të drejtën e redaktimit të materialeve që do të publikohen në faqet e gazetës, në përshtatje me problematikën e ditës, programin e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe hapësirën e mundur. Redaktimet që do të bëhen nuk do ndikojnë në trajtimin thelbësor të problemit, apo informacionit. Gjithashtu redaksia kujton se, nuk ka mundësi të ruaj dhe të kthejë shkrimet e dërguara për botim dhe as fotot, pasi na mungojnë kushtet për një gjë të tillë. Besojmë në mirëkuptimin tuaj.

Faleminderit!
Redaksia e gazetës "Dukagjini"

Mendime për fenomenin e gjakmarrjes



U bën rreth 26 vite që e ecim e ecim duke u marre me fenomenin e gjakmarrjes shume shoqata, fondacione e deri struktura të shtetit Shqiptare, që u i ringjall pas vitit 1990. Në këto vite, kemi lexuar e dëgjuar shume ndodhi, shume shifra, janë bere shume takime, deri dhe ish një President e Republikës së Shqipërisë, i cili ndjen kënaqësi kur mori pjese në pajtimin e dy familjeve, që njëra familje fali gjakun familjes tjetër, deri sa Ministria e Arsimimit që trishtohet shume kur në prehër i vunë vajzën e ngjuar, deri sa edhe një vajze i mësojnë një poezi për gjakmarrjen dhe e detyrojnë ta recitojë në çdo takim, në çdo veprimtari e deri në TV "Top Channel" ... Edhe ketë vit, bëhen dy takime për "luftën" kundër gjakmarrjes. Njëra me datën 4 mars dhe tjetra me datën 20 maj 2016. E para, me teme:

"Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Shoqërinë Civile, institucionet shtetërore dhe me mbështetjen e Universitetit "Luigj Gurakuqi", e organizuar nga Avokati i Popullit! E dyta, me teme "Të lidhim Besën ... për pajtim" e organizuar nga Operazione Colomba-Corpo Nonviolento di Pace della Comunità Papa Giovanni XXIII dhe me mbështetjen e Avokatit të Popullit. Madje, kjo veprimtari nen drejtimin e kësaj organizate ka filluar me datën 19 dhe ka vijuar me datën 20 e 21 maj 2016. Madje na paraqitet dhe një dokument, që ju drejtohet gjithë shoqërisë, gjithë strukturave te shtetit për të marre përgjegjësinë për të lidh besën për pajtim dhe në mes të tjerave është një kërkesë e këtij dokumenti ... "Evidentimi dhe regjistrimi i të gjitha vrasjeve me motiv gjakmarrje dhe hakmarrjeje tëndodhura pas vitit 1990, evidentimi i fëmijëve dhe i personave të ngjuara për shkak të gjakmarrjes, sipas gjinisë dhe grup moshave (meshkuj, femra, të mitur), i anëtarëve të familjeve rivale në hasmëri, si dhe një pasqyrë të zhvillimit të konfliktit...". Por, është interesant, se në asnjë pike të këtij dokumenti nuk kërkohet të evidentohen fëmijët që kane mbete jetim, pasi ju është vrare njeri prind, baba dhe të evidentohen ata pleq, që kane mbete pa përkrahje sociale, sepse ju është vrare djali!!!

Këto dy veprimtari na bën, që të paraqitemi me një opinion të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" për qëndrimin tone ndaj fenomenit të gjakmarrjes, nëpërmjet gazetën tonë, "Dukagjini".

Misioni i shoqatës Atdhetare "Dukagjini", është hulumtimi, studimi dhe publikimi i vlerave të bashkësisë dukagjinase në fushën e historisë e të kulturës, për të cilën nuk kemi punuar pak, aq sa nxjerrim në çdo muaj një gazete modeste, e pagëzuar me emrin "Dukagjini". Por, në punën tone për realizimin e misionit, nuk ka mbete jashtë vëmendjes shqetësimi i fenomenit të gjakmarrjes. Për ketë, në disa raste janë botuar artikuj të ndryshëm kundër këtij fenomeni, në gazetën

"Dukagjini", madje në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe, në kuadrin e Ditës Botërore të Drejtave të Njeriut, me datën 11 dhjetor 2010, kemi organizuar dhe zhvilluar një Simpozium Shkencor, me teme "Gjakmarrja realitet apo retorike", në të cilën kishim dhe miq nga Kosova. Në kuadrin e grupimit "Aleanca për Jetën" kemi zhvilluar disa veprimtari të ndryshme, deri dhe një konferencë me pjesëmarrjen e gjithë faktorëve të pushtetit vendor, me përfaqësi të strukturave të drejtësisë dhe të religjioneve. Pra, pavarësisht, se nuk jemi marre drejtëpërdrejtë me ketë fenomen, ky fenomen na ka shqetësuar dhe jo në pak raste jemi bere pjese e veprimtarive kundër tij.

Po, në analizën tone, çfarë na del?

Shume pyetje më erdhën për momentin, në mendje kur mora këto ftesa, por tre pyetje më mbeten në mendje: *E para*, si është e mundur, që strukturat e shtetit, institucionet shkencore të bien kaq poshtë, sa dhe këta të bëhen pjese e një fenomeni të një shoqërie primitive? *E dyta*, si është e mundur, jo vetëm disa segmente të shtetit i ndajnë shqiptaret në Gege e në Toske, në Verior e në Jugor, në Malokë e në të Emancipuar? *E treta*, si është e mundur, që dhe vete ne, ne Verioret e konsiderojmë veten një bashkësi primitive?

U bën rreth 24-25 vjet, ndoshta edhe më shume që flitet për gjakmarrjen. Mediat, shoqëri civile e aq më shume shoqata apo institucione që merren gjoja me pajtimin e familjeve në gjak, që ne verioret i themi gjakmarrje dhe ngjuohemi, që jugoret vriten, por i thonë hakmarrje dhe nuk ngjuohen. Këta verioret janë malokë, primitiv dhe këta jugorët nuk janë malokë, janë të emancipuar.

Pak histori

I-Në fillimet e proceseve demokratike u krijuan dhe morën statusin juridik shume shoqata për pajtimin e gjaqeve, në një kohe, që ne, historikisht nuk kemi pasur shoqata pajtimi; në një kohe, që ne, nuk ishim të pushtuar nga ndonjë armik dhe duhesh të pajtoheshim për të luftuar armikun, e për ketë na duhesh një Anton Çetë, dhe në një kohe, që shtresa e persekutuar nuk u çua në këmbë për tu hakmarrë. Në Qarkun e Shkodrës, vetëm një rast ka ndodhur, që një i persekutuar mori hak, mori gjak vetëm ndaj atij, që i kishte vrare babën. Atëherë, pse u ngritën këto shoqata dhe ju dha statusi ligjore nga drejtësia shqiptare? A nuk ishte ky moment, moment i papërgjegjshmërisë së strukturave gjyqësore shqiptare? Mendoj, se pa tjetër që po, ishte papërgjegjshmëri e madhe e këtyre strukturave gjyqësore.

Në vitin 1928, në momentin që Ahmet Zogu u vetë-shpall mbret, nxori dekretin, që lejonte në fuqi edhe të drejtën zakonore edhe kodin penal. Për ketë, shkruan profesor doktor Ismet Elezi, në veprën e tij "E drejta zakonore penale e shqiptareve", viti 1983, fq. 41. "Pra, shoqëria shqiptare, në veçanti në pjesën e Mesme dhe Veriore të saj, vijonte të mos njihje shtetin, megjithëse pas vitit 1925, Ai u vendos plotësisht në të gjithë hapësirën territoriale të Shqipërisë, i zbatoi ligjet sipas interesave të veta. Shteti, kur nuk donte, popullsinë e maleve, në pjesën dërmuese të saj e la të vetëqeverisej, mjafton që të mos i prekehshin interesat e tij. Kështu, "... me dekretin e 30 qershorit 1928 (Zogu), për rregullimin e marrëdhënieve të caktuara juridike njihje Kanunin e Leke Dukagjinit dhe kanunin e Skënderbeut, si burim të së drejtës në një kohe kur vepronin ligjet e shtetit shqiptar ...", fq. 28. Çfarë ndodhi 77 vjet më vonë, në muajin maj 2005? Kuvendi i Ynë, nxjerre ligjin, me nr. 9389, date 4 maj 2005, mbi

krijimin e "Këshillit Koordinues për Luftën kundër Gjakmarrjes, me në krye Presidentin e Republikës ...". Përveç këtyre Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dhe nene të veçanta shtesë në Kodin Penal për ndëshkimin e atyre që vrasin për gjakmarrje, krejt i panevojshëm, kur është neni i veçante për vrasjen me paramendim. Pra, gjakmarrjen e ligjëroi shteti, dhe pse ne, nuk kishim gjakmarrje.

2- Jo në pak raste, shkruhet, flitet në media, në konferenca, ... në mes të tjerave, duke thënë "Kanuni i Mesjetës dhe gjithçka në ketë mes e lidhin me Leke Dukagjinit", çka nuk është e vërtetë.

Studiuesi japonez, Kazuhiko Yamamoto, që ka studiuar për të Drejtën Zakonore Shqiptare, duke folur për etiken e kanunit, që janë në përgjithësi: **betimi, miku, ushqimi, gjaku**, vijon: "Ngjashmëria e koncepteve të "mikut-zot" dhe "ushqimit" ndërmjet shqiptareve dhe japonezeve të lashte na shpie ne, të vlerësojmë një koncept fetar të Japonisë së lashte ... "Normat kanunore të jetës primitive ishin kudo në shoqërinë njerëzore të asaj periudhe, të cilat me emancipimin gradual të shoqërisë edhe ato vazhduan të modernizohen për tu përgjigjur kërkesave të kohës". Pra, e Drejta Zakonore, nuk lindi me ardhjen e sistemit Feudal dhe as me lindjen e Leke Dukagjinit, por ka lindur shume herët, që në kohën kur shoqëria njerëzore filloi të jetoje në grup. Shoqëria njerëzore, kur filloi të jetoje në grup nxori rregulla për të bashkëjetuar, por fatkeqësisë e jone është, se nga faktorë të ndryshëm, paraardhësit tanë ndenjëm gjate pa shtet, duke u drejtuar nga e drejta zakonore dhe ne ende jemi me ato mendësi. Pavarësisht, se gjakmarrja ka qene e tmerrshme, por e Drejta Zakonore e ka kufizuar, sigurisht aq sa ka mundur, gjakmarrjen dhe nuk mundet të dalim me atë, që pse ne nuk jemi emancipuar ende për të bashkëjetuar në grup dhe ende nuk po e kuptojmë, se jemi në kohën e një shoqërie të hapur, në themel të cilës janë vlerat e anti-vlerat e individit dhe jo më e rendit fisnore, nuk e ka fajin kanuni.

Mendoj, se përpjekjet për të njohur, për të studiuar dhe për të interpretuar të Drejtën Zakonore janë të cinguar dhe jo qellim mire.

Për ketë, po citojmë disa paragraf të Kanunit: Në faqen 84, paragrafi 870, theksohet: "I dami zjarmit jashta 24 orvet nuk i ruhet ma gjaksi". Në paragrafin 871 theksohet: "Kushrinija e dame me zjarm prej dorërasit mbrenda 24 orve të vrasës do të ruhen, sepse, po i vrau shpija e të vramit, e merr gjakun e vet". Vijon në paragrafin 872 "Po pshuen pa u vra mbas 24 orësh, do të dorzanitet me shpi të të vramit e do të jene të lirë në punë të vet". Përsëri vijon në paragrafin 873 "Po vran kend prej kushrinis së dame shpija e të vramit mbasi të kalojn 24 orët, ajo nuk merr gjak, por bjen në gjak".

Në faqen 86, paragrafin 898, theksohet: "Në kanu të vjetër të Malevet të Shqipnise vetëm dorerasi bijtë në gjak, ase aj, i cilli tërhiqte, shkrepse e shprazte pushkën a çdo arme kundra nieri". Në paragrafin 899 theksohet: "Shpija e të vramit nuk mujte me ndjeke as me vra tjetër kënd prej vllaznish, nipash e kushrijsh të gjakësorit, pose gishtit-dorerasit". Në paragrafin 900, theksohet: "Kanuja e vonshme pershin mashkullin e shpise së dorerasit mje në ferishte djepi; kushrinin e nipat e ngiet, edhe pse të dam, por për 24 ore, në vale të gjakut; mbas 24 orësh do t'u qitte dorëzane shpija e të vramit". Në paragrafin 898, theksohet: "... Vetëm dorërasit bijtë në gjak ..."; në paragrafin 899, theksohet: "... shpija e të vramit nuk mujte me ndjekë as me vra tjetër kënd ... posë gishtit-dorërasit".

I citojmë këto paragrafë për të nxjerre një

përfundim e të pyesim veten, a jemi duke vepruar drejtë?! A po e dimë, se në cilën kohe po kalojmë, në cilën kohe po jetojmë?! Nga ata që janë vrarë për gjakmarrje, që nëbazë të dhënave të strukturave të Ministrisë së Brendshme, nga të vrarët në këto vite, për gjakmarrje janë vrare rreth 7 % e tyre. Në qofte se do të ishte në fuqi e Drejta Zakonore, 90 % e tyre nuk do të ishin vrarë! Ndonjërit ju duket e habitshme, por kjo është e vërteta. Jo në pak raste, për të mbuluar paaftësinë tone, në zgjidhjen e konflikteve, në parandalimin e vrasjeve, në parandalimin e krimin të çdo lloji, ja len fajin atij, që nuk ka asnjë përgjegjësi, i lihet faji kanunit.

Më vjen keq ta them, që ne, jemi ende në një gjendje anarkie. Dhe për t'iu vërtetuar ketë, japim dy shifra. Nga studimi i ynë (studiuesi Prele Milani), na del: Gjate viteve 1747-1909, gjate 162 viteve nën pushtuesin osman, në zonën e Dukagjinit (Shale, Shosh, Pult, Temal e Shllak) janë vrare 82 vete, për arsye nga më tëndryshme, kane humbur 82 jete njerëzish. Ndërsa gjate vitit 1991-2012 janë vrare 145 vete dhe në mes tyre 15 femra, kane humbur jetën 145 vete, që po të ishim në Luftë të Shkallës së Pare, frontale, nuk do të kishim humbur kaq luftëtarë.

Të nderuar lexues të gazetës "Dukagjini", në përgjithësi në Veri e në veçanti në Shkodër, operon Organizata Colombo, të cilët i kam falënderuar dhe i falënderoj për fisnikërinë e tyre, për punën e tyre, madje punën e tyre e kemi publikuar në gazetën "Dukagjini", por në qofte se këta dhe të tjera organizata, në projektet e tyre, nuk do shënojnë fjalën *gjakmarrje*, ata nuk mbështeten nga donator vendas apo të huaj dhe kryesisht të huaj. Në vitin 2014, për një marshim që organizuan dhe e bën, ju bëmë thirrje, të ndryshojnë sloganin e këtij marshimi dhe do ju mbështesim. Slogani ishte "Një popull që lëviz për paqe, kundër gjakmarrjes", I kërkuam ta ndryshojnë "Një popull që lëviz për paqen, kundër dhunës e vrasjes". Ata nuk pranuan, të hiqesh fjalagjakmarrja, edhe pse e kërkuam edhe të tjerë ketë gjë, sepse në të kundërt nuk do të merrnin fonde.

Dhe më e çuditshmja ishte, se ata shkuan vetëm deri në Tirane! Shqipëria nuk është vetëm deri në Tirane, se deri këtu është më pak se gjysma dhe më e keqja është, se ketë ndarje e ligjërojnë edhe disa struktura të shtetit tonë demokratik.

Kjo organizate nuk operon vetëm në Shqipëri! Ajo ka për mision të operojë në gjithë vendet ky ka konflikt etnik të armatosur. Në ketë kohe, Ajo operon në Egjipt, në Siri, në Somali, në Ser Lanka e në të tjera vende në gjendje luftarake. Mos valle Republika e Shqipërisë e në veçanti Veriu e kryeqendra e saj, Shkodra është në gjendje lufte nderetnike??? Jo, kurrsesi jo. Atëherë, këto organizata, pse lejohen të operojnë në vendin tonë?!

Para pak diteve, dëgjova një emision televiziv, në TV1-Channel, për kundër gjakmarrjen dhe që në mes të tjerave u tha, se të operosh duhen pare ...! Me ketë rast, mu kujtua një fisnik, i cili në fillimet e proceseve demokratike, ishte kryetar i një grupi shoqërorë, duke u marre me pajtime ... Pas dy viteve u largova, me tha, se hyri paraja dhe nuk mund të bëhesha pjese e kësaj maskarade ... Gjithashu, me ketë rast, më erdhi në mend dhe një kujtim i para dy viteve; "Një familje ishte e ngjuar, por pas disa kohe i duhesh, që gjakësi ti jepte 30 dite leje ... Thirri pajtuesin dhe i tha problemin. Pajtuesi i kërkojë 15 000 leke (të reja) dhe pas tre ditëve, i kthej përgjigje, se nuk më dha leje ... Shkuan 15 000 leke!?"

(vijon në faqen 9)

MESAZHINGUSHËJIM

Drejtuar: Presidentit të Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare, Imzot Angelo Massafra, SHKODËR

Shkëlqesia Juaj Imzot Massafra,

Me hidhërim të thellë mësuam për largimin e parakohshëm të Ipeshkvit të Sapës, Imzot Lucjan Avgustini, për te Ati Ynë Qiellor. Kjo humbje na ka pikëlluar të gjithëve ashtu siç jemi të sigurt se ka prekur Ju dhe gjithë klerin e Kishës Katolike. Me këtë rast, më lejoni Shkëlqesi që në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë anëtarëve të Shoqatës Atdhetare Dukagjini, t'Ju shpreh Juve dhe gjithë Klerit të Kishës Katolike në Shqipëri, ngushëllimet tona të sinqerta. Në këto ditë të vështira për Kishën, Ju sigurojmë Shkëlqesi, për solidaritetin dhe mbështetjen tone të pa kursyer.

Me respekt, Shoqata Atdhetare "Dukagjini"!
KRYETARI, NDUE SANAJ

MONSINJOR LUÇJANIT

Kam edhe unë foto me ty o MonsinJOR
Por nuk po due me i nxjerrë.
Ç'na duhen fotot që tash majmë në dorë
kur ty tashma t'kem bjerrë.
Ti ike papritmas ashtu siç ikën dielli
Kur reja e mbulon si perde
T'pëlqeu ma shumë udhtimi për kah qielli
Se toka mbush me derte
Na fal po t'lutna se ndoshta nuk ta dhamë
Ç'ke meritue vërtetë
Por t'gjithë do thirrën i ditë në gjyq' të mbarmë
Për çka kan ba n' këtë jetë.
Por ti po shkon ballnalt te Ati jonë qiellor
Se korit kurrë se ke.
Çdo çast të jetës tande me kryq e pendë në dorë
Për fe e për atdhe.
Lamtumirë o burrë i Kosovës kreshnike
E shpirti tu baftë dritë
Do t'kujtojmë me mall se shpejt na ike.
Shpresoj të të shoh një ditë.

Luigj Mila

Ndërroi jetë imzot Luciano Avgustini, ipeshkvi i Dioqezës së Sapës

Dioqeza e Sapës sapo ka njoftuar që ipeshkvi MonsinJOR Luçiano Avgustini ka nderruar jetë. MonsinJOR Luçiano Avgustini ka lindur në Ferizaj të Kosovës me 23 gusht 1963.

Pas Seminarit të Vogël të Suboticës dhe atij të madh në Zagreb me 15 gusht 1989 u shgurua meshtar në Dioqezën Shkup-Prizren. Filloi shërbimin në këtë dioqezë si sekretar ipeshëv ndihmës, Shqëlqesia e tij imzot Nikë Prelës. Që nga viti 1992 kreu njëkohësisht shërbimin e famulltarit të Engjëjve të Rojes në Ferizaj dhe atë të Proçesit të Karitasit të Kosovës. Në vitin 1994 u transferua si meshtar në Dioqezën Metropolitane Shkodër-Pult. Me 1996 u emërua famulltar i Shkodrës pranë Katedrales së Shën Shtjefnit, Shkodër, ndërsa në vitin 1998 u emërua mëkëmbës i përgjithshëm i dioqezës. Ne dhjetor 2006 emrohet ipeshkev i dioqeses së Sapës. Me emrimin e tij në kete dioqes organizoj totalisht famullit, qe prej



vitesh nuk kishte patur meshtar. Ne misionin e tij baritor mori pjese ne çdo fshat te thelle duke qene i pranishem deri ne fshatin me te large te dioqeses ne fshatin Brise te Nikaj-Merturit, takimi me banoret e zonave te thella duke ngrohur zemrat ne ringjallien e fese. Nje ndihme te vecante ka dhene ne vitin 1997 ne vitin e mrapshet te nje lufte civile duke shkuar dhe fjetur ne xhamin e shkodres duke shuar urrejtjen dhe parullat qe ishin perhapur per percarjet fetare duke bashkpunuar me Myftiun e Shkodres. Ka dhene nje ndihme te madhe ne pajtimin e mjaftë familjeve nga fenomeni gjakmarrjes ku kam marre pjese ne keto ngjarje, kur punoja per tv Rozafa. Ne drejtimin e Dioqeses se Sapës ka punuar me perkushtim te madh ne investimet per ndertimin e qendrave te bamirsise per njerzit ne nevojë e te braktisur nga Zadrima deri ne Kukes. Imzot Luçiani ishte zevendes presi-

dent i conferences ipeshkvnore Shqiptare ku mori pjese ne manifestimin paqësor ne Paris se bashku me kreret fetar ndaj ekstremizmit fetar ndaj shtypit te lire. Pjesmarrja ne kete manifestim paqësor pati jehonë ne te gjitha gazetate me te medha franceze duke dhene nje mesazh paqe e harmonie të trojeve shqiptare. Dua te theksoj se imzot Luciani punoj per ngritjen e fese ne zonen e Lekbibajve ku ka nisur punen per hapjen e rruges per ne kishen e Nikajve ne Gjonpepajve. Gjate veprimtarise se tij ka punuar per zbulimin e kishave te vjetra te ketij Dioqesi, qe jane në projekt e siper. Prej shume vitesh pune si kroniste ne televizor, kam perciellë shikusve mesazhet e ketij oratori te fjales se Krishtit. Besimtaret e shumte luten per shpirtin e tij tashma ne amshim. Paç drite Imzot Luçiani.

Pergatiti Zef Nika

MARTIN CAMAJ, SHKRIMTARI I LARTËSIVE

Nga Ismail Kadare

Ndjesia e parë që provon lexuesi kur hyn në botën letrare të Martin Camaj është ajo e lartësisë. Pa përjashtuar përfitimim eufemik të shprehjes, atë që ka lidhje me gjithë shkrimtarët e mëdhenj të një letërsie, te Camaj shprehja merr një kuptim të mirëfilltë. Në shumicën e veprave të tij, në mjediset e përshkruara, në klimën e tyre, te personazhet, ajri, madje dehjet e shëndetshme apo të turbullta që vijnë prej tij, janë ato të alpeve.

Sipas Ernest Koliqit, adhures e njëherësh mentor i shkrimtarit, ky luks gjeografik lidhet me zanafillën e shkrimtarit. Lartësitë e bjeshkëve, më saktë Dukagjini, ku ai kishte lindur, kishin gjetur, më në fund, te biri i tyre, mjetin e vet shprehës.

Është një mendim i fisëm, nga ata që sa ç'kuptohen me lehtësi, aq edhe kanë nevojë për plotësim. Është e vërtetë se visoret dhe klima në veprën e Camaj të kujtojnë shpesh ato të vendeve veriore, madje tepër të skajshme, si Islanda, por ato afrohen çuditërisht me klimën e teatrit grek, nëpërmjet të njëjtit fill të padukshëm që, siç e ka vënë re francezi Jean-Pierre Faye, kultura parake shqiptare përketej me antikitetin.

Drugëtimet e brendshme të ndjeshmërisë artistike mbeten shpesh të pazbuluara prej nesh. Por kjo nuk pengon që në një tjetër hartë ato të kryqëzohen, ashtu siç ndodh me sagat islandeze, doket e vjetra ballkanase dhe artin antik.

Ka gjasë që më shumë se te këto, te vetmia e shkrimtarit të gjendet shkaku i thellë i këtij mënjanimi. Martin Camaj ka qenë, pa dyshim, shkrimtari më i vetmuar shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Duke i strehuar ngjarjet dhe personazhet e veta në një lartësi, që iu siguronte pavarësinë, ka kujtuar ndoshta se do ta mbronte artin e tij prej ndikimit të katrahurës shqiptare, asaj së cilës kujtonte se i kishte lënë lamtumirën.

I larguar tepër i ri nga atdheu, i cili çdo ditë e më tepër bëhej i huaj për të, për shkak të komunizmit, ka kujtuar se atë çfarë ka humbur e ka gjetur disi në Kosovë, por ky nuk mund të ishte veçse një iluzion. Ka ndërruar truall përsëri, madje e ka lënë Gadishullin dramatik të Ballkanit, për një tjetër gadishull, më pak të tillë, atë të Apenineve, gjersa edhe prej andej është larguar përsëri. Po të kishte qenë muzikant ose piktor, më lehtë ndoshta do ta kishte shkëputjen, por arti i tij lidhej me gjuhën shqipe, atë vargor të rëndë, të cilën as mundte e ndoshta as donte ta ndërronte dot. Te viset e ar-

bëreshëve, ku, ashtu si Koliqi, shkonte shpesh, gjente vërtet një spikamë të botës shqiptare, por kishte gjasë që, ndonëse e pabezdisshme prej doktrinës, ajo spikamë e zbehtë, më shumë se zëvendësuese, ishte thjesht një trishtim. E ka kuptuar se përderisa poeti Zef Skiroi, ndonëse i lindur në këto vise, i kishte quajtur megjithatë "te dheu i huaj", aq më tepër do të ishin të tilla për të. Një tjetër Zef, ai i Serembes, një shekull e ca më parë, e kishte shpjeguar të fshehtë:

**Arbëria që prapa detit na kujton
Se ne të huaj jemi te ky dhë.**

Ishte gjithmonë ajo, Shqipëria, që në



epoka të ndryshme rrezatonte të njëjtin trazim. I vendosur më në fund në Lenggries të Bavarisë, në këmbë të alpeve gjermanike, që i kujtonin bjeshkët e Dukagjinit, e ka ndier se ato, në fund të fundit, nuk ishin veçse pamje. E ka ndier përfundimisht se ashtu si Filoktetin antik, me plagosjen e tij të pashërueshme, ai



gjithashtu nuk do ta kapërcente dot mungesën e atdheut. Dhe atëherë, duke e parë se nuk i largohej dot më, ka bërë atë, për të cilën me siguri ka kujtuar se s'do të ndodhte kurrë: të dëgjonte lajme që vinin andej, pikërisht prej katrahurës, së cilës i ishte larguar me aq ngulm. Të dëgjonte ç'ndodhte me atë popull, me zhurmat e tij, me kambanat që po heshtnin, me burrat që kishin ulur kryet, me gratë e hijshme, së fundi me gjuhën shqipe dhe me shkrimtarët dhe fatin e tyre ziplot. Një qerthull, nga ata që duket se krijohen prej harmonive të epërme, po mbyllet, më në fund, për të sqaruar raportet e ndërlikuara të shkrimtarit me lirinë dhe me vendin e vet. Liria dhe Shqipëria ishin të ndara. Së bashku ngjanin ende të pamundura.

Martin Camaj, ashtu siç u qëllon rrallëherë shkrimtarëve, u rrek të kapërcejë pikërisht të pamundurën. Ishte ky epilog që, në trajtë testamentare, u shpreh në fjalët e tij, drejtuar gjithë shqiptarëve, e natyrisht kolegëve të tij, pak kohë përpara se t'i linte lamtumirën kësaj bote: "Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijtë".

2

Letërsia shqipe është krahasuar disa herë me një ngrehinë të rreptë e të ftohtë, gjysmë kështjellë, gjysmë manastir. Fillimet e saj si letërsi murgjish, e kanë nxitur ndoshta një përfitim të tillë.

E paktë, e tkurrur tragjikisht, për shkaqe dhe rrethana që dihen, me një ndalim të gjatë shumëshekullor, me një periudhë dygjuhëshe, latine dhe shqipe, me alfabet të padashur, madje të demonizuar në ceremoni zyrtare fqinjësh, ka mbërritur në shekullin e njëzetë, ku, në kundërshtim me shpresën, e ka pritur një zezonë e re: censura dhe vetëcensura, fajtoje për të cilat nuk ishte askush tjetër veç vetë Shqipërisë.

Ndonëse e tillë, e ngushtë, përherë e pamjaftueshme, spartiate e pa madhësi të jashtme, si të gjitha vlerat shpirtërore të krijuara përmes vështirësish, e rrezatonte megjithatë një hije të rëndë. Ndërkaq, për një paradoks të madh, në vend që të ishte mikpritëse ndaj shkrimtarëve që do të plotësonin mungesat e saj, bënte të kundërtën. Portat e saj rrinin më shumë mbyllur se hapur. Prej tyre ishin nxjerrë përdhunshëm personazhe të mëdha, ikja e të cilave bënte që të ngjanin edhe më të zbrazëta hajtet dhe qelat e saj.

Përpara këtyre portave u gjend një ditë Martin Camaj. Nuk ishte i nxjerrë jashtë mureve, si Fishta, Konica, Koliqi, por kjo nuk e bënte më pak të ndërlikuar problemin e

tij. Kishte qenë thjesht nënshtetas i atij vendi që quhej Shqipëri, por asnjëherë brenda kullës letrare. Ka gjasë që për një kohë të gjatë, në nënvetëdijen e tij shestohej e paarrtshmjia: të bënte pjesë një ditë në atë fis apo në atë urdhër trillan.

Brenda kullës, përveç hijeve të mëdha, ishin shkrimtarë të gjallë, të ngjashëm me ta, por të padashur, si Lasgush Poradeci ose Mitrush Kuteli. Siç ishin të pakuptueshëm për epokën brenda së cilës u gjendën, ashtu do të ishin më pas, kur epoka të ndërrohej. Studiuësit do ta kishin më të lehtë të pohonin se, meqenëse në një epokë të tillë mizore nuk mund të krijohej letërsi, ata e kishin braktisur krijimin letrar. Ndërkaq, pikërisht në kohën e vështirë ishin krijuar disa nga perlat më të çmuara të të gjitha epokave, si vjershat "Gremina" dhe "Flaka" të Poradecit ose "E madhe është gjëma e mëkatit" e Kulelit e ndoshta të tjera vlera, që do të zbuloheshin më pas. Pyetje të shumta do të lindnin: ç'do të bëhej me këto perla? Do të mohoheshin, ngaqë bezdisnin klishtë dhe mendjet e ngushta, apo mashtrueshëm do të kalonin në tjetër kohë? Edhe më të vështira do të ishin pyetjet për aradhen e shkrimtarëve që kishin lindur ose ishin rritur në epokën që quhej e gabuar. Për shkak të saj, e pas rrëzimit të saj, ata do të quheshin gjithashtu të gabuar e do të binin bashkë me epokën apo fati i tyre do të vendosej pas ligjesh të tjera, e nga një tjetër verdikt?

Martin Camaj nuk i lejoi vetes asnjëherë që, duke përfitur prej lirisë që i jepte mërgimi të shkruante kundër sivilizimit të tij në Shqipëri. Ishte e vërtetë se në kohën që ai kujtohej e bëhej merak për ta, ata nuk u kujtuan kurrë për të, por kjo nuk e shtyu asnjëherë t'u mbante mëri për shpërfilljen apo harresën e tyre të gjatë. Ishte i ndjeshëm për gjendjen e tyre, për optimizmin e rremë e për ankthin e fshehur me kujdes midis festës po aq të rreme. Në vetmi, rrallëherë i kuptuar nga njerëzit, Camaj vazhdonte veprën e tij, duke u përpjekur të ruante dritësimin e saj alpin, qoftë në poezitë, qoftë në prozën e tij. Ishte pakti i tij i pandryshueshëm me artin, me lartësitë e bjeshkëve nga kishte dalë, e ku një ditë shpresonte se do të kthehej.

S'due me qenë si moti i lig kumtonte në një nga vjershat, duke shpallur kështu kthjelltësinë e fisme mbi mlllefet, e sidomos mbi mlllefet, pa të cilat ishte vështirë të përftohej bota shqiptare. "Poezia shihet si formulë për ngadhënjimin e tragjikës", shkruante për veprën e tij poetike studiuësja gjermane E. Glaser. Ai vetë do të sqaronte se "prej letërsisë kam pasë gjithçka, edhe vullnetin për të jetue". Që nga përmbledhja e parë "Një fyell në male" e vitit 1953, në Prishtinë, e gjer te "Palimpse-

HALIL VOGLI, RREZATOI KUDO NDERSHMËRI DHE PËRKUSHTIM

1941 në një familje të mesme të kohës. Shkollën 7 vjeçare e mbaroi në vendlindje. Që në moshë të re filloi të punonte në prodhim në ish kooperativën bujqësore në Babullush që në vitin 1956. Arsimin e mesmen ekonomik e ka mbaruar në Tiranë në vitet 1964-1967. Që nga kjo kohë ngarkohet gjithnjë me detyra të ndryshme ne Barbullush, si në kryetar i degës e planit, përgjegjës sektori Duke parë vlerat e tij, në vitin 1971 emrohet kryetar i kooperativës bujqësore në Shosh-Dukagjin ku qëndroi deri në vitin 1976. Nga aty transferohet në kooperativën bujqësore Shalë që punoi për tri vite. Në vitin 1979 deri 1988 ishte kryetar i kooperativës në Mjedë. Ai ka mbaruar shkollën e lartë të filozofisë në Tiranë me rezultate mjaft të mira. Në legjislaturën e 11 të Kuvendit Popullor të Shqipërisë është zgjedhur deputet. Nga viti 1988 deri me daljen në pension punoi në detyra të ndryshme në zonën e Barbullushit.



Për punën e tij të mirë është dekoruar me urdhërin e punës të klasit të tretë dhe më vonë me urdhërin e punës të klasit të parë. Halil Vogli ishte komunikues mjaft i mirë dhe mjaftë popullor, ishte i thjeshtë dhe shumë aktiv kudo që ka punuar, i pjekur dhe punonte me ndershmëri.

Familja e Halil Vogliit ishte e lidhur me levizjen nacionalçlirimtare. Babai i tij ka qenë partizan në brigadën e 23 sulmuese të ushtrisë partizane. Kudo ku punoj në Dukagjin e shoqëronte bashkëshortja e tij, Sabrie, një grue shumë e thjeshtë dhe shumë punëtore, pa pretendime dhe dashamirëse sikur të ishte banore e lindur dhe rritur në Dukagjin. Ata lindën dy djem që e kaluan kohën e fëmijërisë në Dukagjin. Fëmijet e tyre trashëguan tiparet e mirë të prindërve të tyre dhe i kanë bërë vend vetes kudo në punë e shoqëri. Edhe pas ndryshimit të sistemit në fillim të viteve '90, Halil Vogli gëzonte respekt nga komuniteti sepse ishte ai respekt që kishte fituar gjatë punës në pozicione të ndryshme, kudo që punoi, punë e cila rezatoi ndershmëri e përkushtim, pavarësisht kushteve dhe vështirësive të kohës.

Duhet vënë në dukje porosia që Halil Vogli i la familjes dhe shokëve kur të vinte koha e përcjdhjes për në banesën e fundit. Ai la porosi të veçanta jo vetëm për ceremoninë në përgjithësi, por veçanërisht për të pritur dhe përcjellur miqtë e shokët nga Dukagjini, ashtu siç presin dhe përcjellin dukagjinasi. Kjo porosi u zbatua me shumë respekt, por edhe komuniteti dukagjinasi e nderoi dhe e përcolli me shumë respekt. Halil Vogli u nda nga kjo jetë pak kohë më parë, por, do të kujtohet me shumë respekt nga familja, shokë e miq, dhe nga të gjitha ata që e njohën.

NDUE MICI

stii", i botuar më 1991 në Munihi e Nju-Jork, pak kohë përpara vdekjes, shtrihen dyzet vite krijimtarie të pandërprerë poetike. Poezisë së tij, ndonëse e një drejtimi që gabimisht dukej i huaj në letrat shqipe, modernizmit evropian, kryesisht hermetizmit, përkundër paragjykimeve shkollareske, i shkon natyrshëm kostumi shqiptar. Arti i madh është njëherësh i kohës e i gjithkohës. "Këngët e Milosaos" e De Radës, e cila disa vite më pas do të mbushë dy shekuj jetë, na tingëllon po aq e freskët e moderne sot, sa në vitet kur u shkrua. Në art asgjë e epërme nuk është e përjashtuar, e aq më pak përjashtuese. Kështu janë poezitë e Camaj, romani i shkurtër "Djella", me shoqërimin poetik, që si një pasqyrë iu hap udhë rreshtave të prozës, veprat e tjera, si "Dranja" dhe "Karpa", ku në të parën u rrek të sendërgojë fatalitetin a mallkimin, me fjalë të tjera, të rrokë të parrokshmen e të shprehë të pashprehshmen, tundim jo i rrallë i shkrimtarëve. Ndërkohë në të dytën përpqet të shkojë edhe më larg, i ndjellë prej një magjistarëre lojcake, gjuhës shqipe, prej përdorimit të së cilës, siç thotë vetë: "e kam ndie veten shpesh virtuoz, d.m.th, jam në gjendje të thom shqip gjithçka due!". E po kështu vijjnë veprat e tjera, si romani "Rrathët", dy dramet e përkora, për të mbërritur te novelat e gjata, "Pishtarët e natës" dhe "Rrunggajat në mars", ato

"fletë të lume" në letrat shqipe, po të përdornim shprehjen e Koliqit, e që ndoshta përbëjnë majën më të lartë të artit të tij.

3

Në tetorin e vitit 1981, një nga stinët më të zyrtarë të tiranisë shqiptare, rrethanat e sollën të takoj Martin Camajn. Isha i ftuar në Panairin ndërkombëtar të Librit në Frankfurt, kur, në mbarim të një konference shtypi, gjatë së cilës iu isha përgjigjur pyetjeve jo të lehta të gazetarëve, m'u afrua një burrë i gjatë e i hijshëm që, me njëfarë mëdyshjeje, më foli shqip: quhem Martin Camaj, a mund t'ju flas? E kisha dëgjuar emrin e tij, madje diçka kisha lexuar prej tij në revistën "Shejzat" të Koliqit, që botohej në Romë e gjendej me vështirësi në Tiranë. I thashë, natyrisht që mund të flisim dhe ai shtoi se kishte ardhur enkas nga Munihi për të më dëgjuar. Një mik i tij shqiptar që e shoqëronte, ka përshkruar vite më pas në shtypin e diasporës ato pak minuta të takimit, kryesisht mëdyshjen dhe shqetësimin e tij se mos, duke më folur, më dëmtonte. Ishim aty, në atë sallë të zhurmshme, shkrimtarë të të njëjtit vend e të së njëjtës gjuhë, por të largët si dy qenie, më saktë, dy fantazma të planetëve të ndryshëm. Ishim dy Filoktetë, gjithmonë me të njëjtën plagosje të njohur të pashërueshme, njëri që e kishte atdheun,

NDUE CUKELI ATDHETAR I NDERUAR

Në hyrje të kabinetit të punës së tij kishte vendosur portretin e patriotit Gjon Marashi, i veshur me rrobat e traditës dhe me pushkë në dorë. Kjo tërhiqte vëmendjen dhe të ngjallte krenari. Ai edhe në librat që ka shkruar, tregon dashuri për origjinën, aty flitet për Shalën, Orën e Shalës,, etj, dhe vërtetë ky emër lakohej disa herë edhe në Rrafshin e Dukagjinit në Kosovë. Në rrethinat e qytetit të Pejës shtrihet Shala e Isniqit. Aty e ka origjinën heroi Isa Boletini. Familja e tij u largua dhe u vendos në Boletin të Mitrovicës, ku pastaj shkuan edhe shumë dukagjinasi të tjerë dhe kështu u krijua Shala e Mitrovicës. Po kështu edhe afër Gjakovës ndodhet Shala e Bajgorës, gjithashtu edhe Shala e Podujevës. Megjithatë, ata pas pushtimit osman në vitin 1479, u konvertuan në besimin islam, origjinën e tyre e ruajtën. Kështu edhe poetët e shquar që shërbyen pranë Portës së Lartë në Stambollë si Sabri Dukagjinzade e ruajtën origjinën e tyre si dukagjinasi. Kjo për ata është shfaqje e atdhetarisë, ndërsa për në është krenari. "Ora" që përmendët ndër legjenda, është shprehje e inisiativës dhe vetëveprimi për banorët dukagjinasi, por edhe më gjerë, është tipar i krenarisë që ndikon në afirmimin e personalitetit të njeriut.



Ndue Cukeli rrjedh nga Abati i Shalës, në një familje tradicionalisht fisnike e patriote, në familjen e Cukel Delisë i njohur për urtësi dhe aftësi të mira shoqërore në të gjitha ngjarjet që ishin korrente në zonën e Shalës në atë kohë. Drejtuesit fisnorë të krahinës së Dukagjinit, gjithnjë kanë treguar aftësi dhe kanë qenë pranë të gjitha problemeve të bashkëfshatarëve të tyre dhe në ndihmë për të zgjidhur problemet e mbijetesës së tyre, për të ruajtur dhe transmetuar brezave besim dhe traditat ndër shekuj.

As këndvështrimi i luftës së klasave, as arroganca ndaj fesë dhe as izolimi i tejskajshëm nuk përputheshin me doktrinën përfaqësuese në politikën e kohës, por një deviacion ultramajtist, pasojat e të cilit janë të njohura tashmë.

Ndue Cukeli u lind me 13.6.1929, pra 87 vjet më parë. Ai ishte oficer karriere dhe ka kryer detyra të rëndësishme gjatë punës së tij në ushtri. Ai qe i respektuar në punë dhe në shoqëri. Ishte i thjeshtë dhe me kulturë. Të impononte respekt. Vdekjen e tij e quaj një humbje për të gjithë ata që e kanë njohur, për familjarët dhe të gjithë shokët dhe miqtë.

Ai u largua nga kjo botë duke lënë pas kujtimin e mirë për të cilin do të kujtohet gjithnjë me respekt.

PJETËR DELIA, NDUE MICI

por jo lirinë, tjetri, me liri, por pa atdhe.

Folëm diçka, në vështrim të parë të rëndomtë, por që, me siguri, nuk kishte të bënte me atë çka do të duhej të flisnim. Rreth dhjetë vite më pas, Eerner Daum, intelektual dhe diplomat i shkëlqyer gjerman, mik i përbashkët imi dhe i tij, personazh i dorës së parë në ngjarjet dramatike të Tiranës 1990, më ka takuar në Paris, për të më sjellë ndër të tjera përshëndetje nga Martin Camaj. Me ndërmjetësinë e diplomatit u vendos midis nesh një shkëmbim i përkorë mesazhesh, madje u caktua dhe një takim në Munihi, ku do të udhëtoja dy muaj më pas, në mars të vitit 1992, në një forum ndërkombëtar shkrimtarësh.

Ky takim nuk ndodhi kurrë, për shkak të ikjes së tij të parakohshme, pikërisht në muajin mars të atij viti. S'më mbetej veçse, me ndihmën e shoqërueses sime, gazetares së "Frankfurter Rundschau", Verena Nolte, që e njihte dhe e çmonte, të kërkoja varrezën ku pushonte, për të vënë një tufë lulesh sipër tij.

Nëpërmjet Eerner Daum-it, kisha arritur t'i tejçoj disa mendime për veprën e tij. Por ato ishin tepër të pakta në krahasim me atë çka do të duhej të thuhej. Një pjesë e tyre janë shprehur në këtë hyrje të botimit të veprave të tij të plota, tetëmbëdhjetë vite më pas, e gjithmonë janë pak. Të tjerat e kanë kohën e tyre përpara, atëherë kur vepra e shkrim-

tarit do të ketë qasjen e saj të plotë të lexuesit, atje ku nis një jetë tjetër e artit të letrave, ajo që përtëritet prore, në pafundësi. Epokat dhe popujt zakonisht nuk bëjnë gabime në vlerësimin e artit të madh. Edhe kur gabimet ndodhin, nuk janë veçse të përkohshme. Gjithmonë vjen ora kur të vonuarit mbërrijnë dhe të munguarit shfaqen. Kështu kanë për të zënë vendet e tyre Anton Pashku i Kosovës dhe Zef Zorba i heshtur, dhe të tjerë ndoshta, të cilët, prej rastit ose rrethanave, janë penguar diku.

Tiranitë, krahas nervozizmit dhe stuhive kalimtare, janë përpjekur të krijojnë portat e rreme e të gabuara. Në ngrehinën e përkorë të letrave shqipe, atje ku është duke zënë vendin e vet Martin Camaj, ashtu si në çdo panteon, hyhet vetëm prej një porte, asaj të madhes. E ajo portë, siç e tregon emri, nuk njeh veçse arsyet e mëdha.

Siç është thënë dikur, De Rada i paharueshëm, në një përshkrim të natës së pashkëve, ka rrëfyer për "engjëjt që e bëjnë veç gostinë e tyre". Në tryezën e epërme, ku kanë zënë vend krenajat e letërsisë, nuk ngjiten zhurmat e vogla e as afrohen profilet e rëndomta. Atje ka përherë mirëkuptim e harmoni, ndaj e krenjtja vazhdon përherë dhe ndriçimi i shandanëve nuk sos.

NË TRADITË KULTURORE

Reportazh nga Manifestimi “Zëri i Vëllazërisë 2016”

Në vazhdim të traditës disavjeçare që kemi krijuar me datën 28, 29, 30 prill u zhvillua veprimtaria, Manifestimi “Zëri i Vëllazërit-2016”, që ne ishim pjese e tij.

Në baze të programit të miratuar nga grupi organizator i të gjitha shoqatave pjesëmarrëse, me datën 28 prill, Manifestimi filloi në qytetin e Shkodrës.

Miqtë nga Peja, u pritën në ora 11. 30, te monumenti Isa Boletinit. Në takim ishte Gjergj Leqejza, Luigj Shyti, Prele Shytani, Roza Pjetri, Zef e Xhovana Sokoli. Ata ishin Ukshin Jashari, Frashër Racaj, Vesel Nikçi, e të tjerë

Të gjithë së bashku bëmë homazhe në monumentin e Isa Boletinit. Pastaj shkuam te monumenti i Mehmet Shpendit, Luigj Gurakuqit e Nene Terezës, ku u vendosën kurora me lule dhe u bën fotografi. Në orën 13. 00 bëmë takim me Kryetaren e Këshillit të Qarkut Shkodër, zonjën Greta Bardeli. Na priti sekretari i Këshillit, zoti Gjon Marku dhe pastaj zonja Greta në një pritje shume vëllazërore, shume miqësore. Pasi u njohëm me përbërjen e Qarkut, na dhuruan nga një album të Qarkut, bëmë foto, biseduam me miqtë nga Kosova për bashkëpunimin e tyre me pushtetin lokal atje ... Ne, i uruam dhe i falënderuam përfaqësuesit e Këshillit të Qarkut për pritjen e në veçanti zonjës Greta, në detyrën fisnike të Kryetares të këtij Këshilli.

Pak me vonë patëm planifikuar takim me Kryetaren e Bashkisë, zonja Voltana Ademi, në vend të cilës na priti N/kryetari i Bashkisë, zoti Arben Gjuraj. Një pritje mjaft miqësore, mjaft vlerësuese dhe pasi na njohu me Bashkinë e Shkodrës, me ndryshimet e kohëve të fundit, bëmë foto dhe na dhuruan nga një album të fototekës Marubi dhe të qytetit Shkodër.

Si gjithmonë me mjaft vështirësi, por me zemër te bardhe dhe me shume dashuri i ftuam miqtë nga Kosova në një dreke në ambientet e bar-restorant “Floga”. Për pritjen miqësore falënderojmë anëtarin e shoqatës dhe mikun e përhershëm të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe të miqve të saj, zotin Lulash Gjelosh Martini, që na është gjendur pranë në çdo rast.

Pasdite u nisëm për në Tuz, ku na priti Pal Dreshaj, N/Kryetari i Shoqatës “Martin Dreshaj” ... Pas një kafe çlodhëse, shkuam e bëmë homazhe te varri i Martin Dreshajt, emrin e të cilit ka kjo shoqate, Shoqata e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe, me qendër në Peje. Pastaj bëmë vizite te Muzeu Shtjefen Ivezaj

Mjaft mbresëlënëse puna e këtij artisti patriot të cilit i ka borxh i gjithë Malësia dhe shqiptaria, por ne si shoqate e ndiejmë detyrim moral që të bëjmë diçka për ta nderuar dhe vlerësuar këtë njeri shpirt mall. Për këtë, Shoqata Atdhetare

“Dukagjini” do të marre nismën, që në bashkëpunim me Shoqatën “Dede Gjon Luli”, me qendër në Tuz dhe Shoqatën e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Peje, ti propozojmë Presidentit te Republikës se

Shqipërisë, për ta vlerësuar me urdhrin e larte “Nderi I Kombit”.

Në mbrëmje para se të fillonte koncerti, të pranishmit ndoqën një ekspozitë fotografike të punimeve me gurë, të mjeshtrit Dukagjinas Mitër Ndreshaj i cili punon që prej 22 vitesh në Mal të Zi.

Në orën 19. 30 filloi koncerti. Një interesim modest i publikut, por këngëtarët tanë lanë një pwrshypje majftw tw mirw. Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini, përshëndeti të pranishmit kryetari Ndue Sanaj.

Nuk mund të largoheshim pa një darkë vëllazërore dhe shume bujare, siç e ka në tradite Malësia. Një darke me shume respekt e shtruar nga Pal Dreshaj. Biseduam, kënduam, por edhe pimë pak, u kënaqëm dhe ndenjëm deri në orët e vona


Nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” u përfaqësua nga një grup antare e aktivistë te saj, Ndue Sanaj, Luigj e Gjyste Shyti, Gjin e Majlinda Dermani. Ermal e Armira Lera, Prele Shytani, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Lulash Brigja, Rajmonda Rugji e Tringa Rapi, Pëllumb Vrinca me bashkëshorten e tij, Ndue Mici, Zef Sokoli, Kole Hasani, Mark Vata, Kristian Zalli, Zef Marku, mjeshtri Miter Ndreshaj dhe Daniel Kopsaj. ... U bë një paraqitje e mire, nderuam Dukagjinin e Shkodrën ...

Me datën 29 prill, në orën 09. 00 u nisëm për në komunën e Istogut. Grupi i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” përbehej: Ndue Sanaj, Luigj e Gjyste Shyti, Gjin e Majlinda Dermani, Ermal e Armira Lera, Prele Shytani, Ndue Mici, Dukate Bregu, Trina Rapi e Rajmonda Sokoli, Mark Vata, Kole Hasani, Kristian Zalli, Zef Marku, Daniel Kopsaj, Zef e Xhovana Sokoli, dhe Lulash Brigja. Gjithsejte 20 vete.

Me kohe e kishim planifikuar një vizite në shkollën 9 vjeçare “Martin Camaj”, në Gurrakoc. Na priti drejtoresha, Mimoza Osmani, me personelin mësimdhënës të shkollës. Një pritje shume miqësore. Na kishin rezervuar një koktej, në të cilin përshëndetën drejtuesit e grupeve dhe pastaj vizituam mjediset e shkollës, u larguam, me përshtypjet më të mira.

Si gjithmonë drejtuesit lokal në Kosove janë treguar mjaft miqësor dhe vlerësues me ne. Na priti në takim N/Kryetari i Komunës Istog zoti Lulëzim Blakaj. Një takim shume miqësor. Pasi na uroi mirëseardhjen, na njohu me historinë e kësaj komune. Ne e falënderuam për pritjen, Pastaj dolëm dhe shkuam në pallatin e kulturës.

Një koncert i organizuar mjaft mire. Mori pjese edhe ansambli





“Mirëdita”, më në krye Fran Preçin.

Ansambli i Valleve “Dardania” nga Drenica e Skenderajt. Pas koncertit, komuna e Istogut, në ambientet e restorant “Trofta” shtroi një darke për të gjithë pjesëmarrësit në këtë Manifestim.

Me 30 prill, pjesëmarrësit vizituan luginën e Rugovës deri te Bar-Restorant “Bjeshka”. Në këtë restorant vloi kënga e vallja nga pjesëmarrësit tanë. Ka qene një kërkesë e vazhdueshme e grupit për të vizituar këtë perlë të natyrës që atje dora e njeriut është treguar mjaft bujare dhe e kujdesshme.

Pas pamjes së mrekullueshme e fotove pa mbarim, vizituam kishën e Shën Katerines. Një kishë e ndërtuar në vitin 1927. Famullitari i saj na priti me shume respekt dhe na tregoi për historikun e saj.

Pas kësaj vizite, Kryesia e Shoqatës “Martin Dreshaj”, te Bar-Restorante “Vëllezërit Luka” na shtruan një dreke me shume bujari, e cila vijoi me këngë e valle nga këngëtarët tanë.

Pak nga pak orët e qëndrimit në Kosove po mbaronin dhe manifestimit po i vinte fundi. Mbresa, kujtime, takime dhe vlerësime

Zotit Pal Dreshaj, Nënkrjetari i Shoqatës “Martin Dreshaj”, i dhuruam një pamje nga qyteti i Shkodrës dhe albumin e Qarkut Shkodër.

Po, të njëjtën gjë dhuruam edhe për Kryetarin e Komunës Istog, zotit Haki Rugova, së bashku me një faqore rakie ...

Në këtë atmosfere u mbyll për këtë vit

Manifestimi “Zëri i Vëllazërimit. -2016”.

Falënderojmë gjithë grupin përfaqësues të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, në mënyrë të veçante këngëtarët Kole Hasani, Mark Vata, Pëllumb Vrinca, Daniel Kopsaj, Zef Marku e Kristian Zalli. Falënderojmë Organizatorin e Manifestimit në Tuz, Pal Dreshaj, Shtjefen Ivezaj e Gjon Dushaj.

Falënderojmë komunën e Istogut, N/ kryetarin e komunës, zotin Lulëzim Blakaj; Drejtoreshën e shkollës 9 vjeçare “Martin Camaj”, zonjën Mimoza Osmanaj për pritjen e bujarinë e tyre!

Falënderojmë Grupin e valleve “Rugova”, me kryetarin e tij, Vasel Nikçi!

Falënderojmë Kryesinë e Shoqatës “Martin Dreshaj” dhe në mënyrë të veçante Kryetarin e saj, Ukshin Jashari, sekretarin e saj, Frashër Racaj për organizimin e këtij manifestimi, përkushtimin e kushtet e krijuara për pjesëmarrësit!

Falënderojmë biznesmenin Lubo Stanaj, për bujarinë e tij, që na dha mundësinë të marrim pjesë në këtë manifestim.

Mire u takofshim në manifestime e veprimtari të tjera kulturore e artistike, në shërbim të ruajtjes të traditave dhe trashëgimisë tone kulturore dhe historike.

Le të mbeten këto reshta dhe këto foto që po përcjellim, për lexuesit e gazetës “Dukagjini” një kujtim dhe shije e veçante

Përgatiti Lulash Brigja



10 VJET SHOQATA "ATDHEHARE DUKAGJINI", DEGA TIRANE

Me datën 30 prill 2016, ne mjesdit e Muzeut Kombëtar, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Dega Tirane, organizoj një veprimtari promovuese të botimit të librit "10 vjet Shoqata "Atdhetare Dukagjini", Dega Tiranë, botim i pergatitur nga Zef Gjeta dhe Zef Bari.

Morën pjesë antare të shoqates dhe miq e të ftuar. Veprimtaria u mbështet nga anëtarit themelues i deges Tirane, ing. Gjergj Voci. Veprimtaria u mbyll me një koktej.

Përhëndetje e z. Zef Bari, kryetari i degës, ne promovimin e botimit

Të nderuar pjesëmarrës, anëtare dhe dashamires të degës të shoqatës Atdhetare "Dukagjini" për Tiranen. Mirë se keni ardhur! Ne dukagjinast e kemi pasur zakon, që nëse i bëjmë një trevese pjesëmarrës për një rast të caktuar, kemi qefte ta shtojmë e ta rrisim, me dashamirë, të afërm dhe miq.

Për këtë arsye në këtë takim, kemi ftuar dhe përfaqësues nga shoqata e "Nikaj Mërturit", të "Shoqatës Mirdita" të "Shoqatës Qendra Alpet" atë të "Curraj Eper" e të tjerë.

Ndjejemi mirë dhe të gëzuar, ne kryesia e degës të Shoqatës Dukagjini dega Tirane, kur takohemi njihemi, bisedojmë dhe gëzojmë me njeri tjetrin, sepse na lidhe gjaku, zakonet, traditat e mira, na lidh emri i Dukagjinit, nga kemi ardhur, emër i cili është gdhendur me germe të arta në altarin e shenjtë të kombit tonë. E gdhenden prijësit dhe luftëtarët në beteja, burrat e urtë në kuvende, njerëzit e penës dhe të dijes, artistet e skenës dhe të ekranit, doktorët dhe profesorët e universiteteve, sportistët rekordmen, kompozitorët, krijuesit dhe interpretuesit e muzikës, drejtues dikasteresh, të të gjitha niveleve, klerikë patriot, që u martirizuan, për fe dhe atdhe, bij e bija të Dukagjinit, që ia rriten vlerat kësaj zone, nder vite dhe dekada.

Është detyrë e shoqatës tonë dhe e çdo dege të saj, këto vlera të evidentohen, të grumbullohen dhe të shkruhen si argument dhe pasaportë identiteti, në duart e fëmijëve tanë, nipave dhe mbesave, brezave që do të na trashëgojnë.

Të nderuar pjesëmarrës!

Meqënëse jemi si një familje e madhe dhe kemi nevojë, për informim, për gëzimet dhe mërzitë, që mund të kalojë çdo familje e bashkësisë sonë, këtu në Tiranë, e ndjej detyrim, tu informoj, për ata që ndoshta nuk e dine, se këta gjashtë muajt e fundit, janë ndarë nga jeta, katër anëtare dhe dashamirës të degës të shoqatës tonë:

Zef Gjeloshi, Anëtar i Kryesisë të Degës të Shoqatës tonë, që nga krijimi i saj. Pati

punuar ushtarak, me shumë devotshmëri derisa doli në pension.

Zojë Kola, bija e Nënnavriqit të Shalës. Ajo, që e vogël ne vitet 60, kur femra dukagjinase, por edhe më gjere ti këndonte dhe ti binte çiftelisë. Zoja këndoi dhe e shoqëroi me çifteli vetë këngën e saj. Kur u rrit ajo që nder femrat e para, që zotëroi profesionin e shoferes. Ka jetuar që në fund të viteve 60 ne zonën e Kamzës.

Lazër Fusha e Fran Dardha, mësues e drejtues shembullor në shumë shkolla të fshatrave, të zonës të Dukagjinit. Aktiviste të dalluar shoqërorë, e familjarë të përkushtuar.

çdo dukagjinast, që është ndërë mirë me emrin që mban kjo shoqatë, me misionin që ka marrë përsipër, duke mos paragjykuar prirjet politike, ndarje fisesh dhe bajraqesh, por duke shtuar njohjen, respektin e bashkëpunimin me njeri tjetrin, duke u përfaqësuar me vlerat më të mira të zonës tonë, për të qenë sa më të integruar me normat dhe rregullat e shoqërisë që na imponon koha dhe zhvillimi.

Këtë qellim kemi pasur edhe te libri, që po promovojnë sot, duke përzgjedhur nga çdo fushë njerëz me kontribute e vlera, që kanë dhënë dhe po japin shem-

të jetosh në Tiranë, me aftësitë e tyre, për nevojat që kishte shteti dhe shoqëria për kontributin e tyre, dukagjinast u bën pjesë aktiv, në çdo sektor të zhvillimit të kryeqytetit. Këta individ me këto vlera i kemi të evidentuar dhe do ti ekspozojmë herë pas here në gazetën e shoqatës tonë dhe në botime të veçanta.

Shumë figura e personalitete dukagjinast, njiheshin jo vetëm nga populli i Tiranës, por dhe nga e gjitha Shqipëria. Në prag të ndryshimit të sistemit, në fillim të viteve 90, në Tiranë jetonin artistet e Popullit Pjetër Gjoka, Ndreku Luca e Tinga Kurti, profesorët dhe doktorët, Zef Celi, Ndok Marku, Zef Shoshi, vëllezërit Voca me shumë kontribute, vëllezërit Radoja, e të tjerë.

Periudha e migrimit dhe e emigrimit, kur njerëzit u larguan nga vendlindja e tyre, duke u vendosur afër zonave urbane ose jashtë vendit, e bënë të domosdoshme krijimin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për të mbajtur, të lidhur sa më shumë me vendin nga e kanë prejardhjen, me gjakun, familjen, zakonet e mira, me historinë dhe çdo gjë që është e veçantë, e duhet ruajtur e mbrojtur si vlerë e trashëguar nga të parët tanë.

Për këtë arsye dega e shoqatës tonë, me një grup intelektualësh, ka përcaktuar objektiva të qarta lidhur me familjet që kanë emigruar nga Tirana dhe rrethinat që janë dukagjinast, duke evidentuar vendin, shkallën e integritit, punësimin, problemet dhe arritjet.

Në veçanti, ne si degë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për Tiranen kemi evidentuar dhe ndjekim me vëmendje përparimin e shumë studentëve dukagjinast, në përgjithësi, e në veçanti, ata që studiojnë larg atdheut e familjeve të tyre, si:

- Donald Zef Gjeta – për arkitekturë në SHBA;
- Orion Gjon Fierza – për Ekonomi Finance Publike në Gjermani;
- Lodia Lazer Stani – Inxhinieri elektronike në SHBA;
- Sindrit Ndoc Çardaku – Biologji Molekulare në Angli;
- Armando Zef Bari – për Administrim Biznes në Francë;
- Drilon Ndue Shurlaj – për Diplomaci Itali, e të tjerë.

Pra dega e shoqatës tonë, ka shumë punë, e presim shumë aktivitete në shërbim të rritjes të vlerave të bashkësisë sonë, i cili çdo ditë po rritet e prezantohet në Tiranë, jo si komunitet i vogël, e në minorance, por si zë i fuqishëm, e forcë integruese e konkurruese, në çdo aspekt të jetës e të zhvillimit.

Le të bashkëpunojmë, të jemi më pranë njeri-tjetrit, të mbrojmë vlerat e mira që kemi, e të fitojmë të tjera për të ardhmen.

Përgatiti për botim dhe fotot
Gjon Fierza



Në shenjë mirënjohje dhe respekti, për ata ju ftoj, të ngrihem i të mbajmë një minutë heshtje... I përjetshëm qofte kujtimi i tyre!

Për këtë qellim, po promovojmë edhe këtë libër që kemi në duar ne sot, me disa nga dukagjinast, që kana kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë, në çdo fushë me dinjitet, në qytetin e Tiranës dhe rrethinat e saj.

Është meritë, e anëtarit të kryesisë të degës të shoqatës tonë, aktivistë, shkrimtarit e publicistit të njohur prof. Zef Gjeta, që bëri të mundur botimin e këtij libri, si vëllim i parë dhe nisen, për botime të tjera të këtij lloji në të ardhmen. Dega e shoqatës tonë ka pritur më kënaqësi,

bullin e tyre në punë, familje e shoqëri dhe që meritojnë të flitet e të shkruhet për këta individ.

Është nder objektivat e rëndësishme tonat, të studiojmë e të gërhojmë, aty ku gjejmë fakte dhe argument, se kur kanë banuar të parët dukagjinast në Tiranë. Kemi informacion, se kanë banuar këtu dukagjinast para viteve 30 të shekullit të kaluar, por nuk kemi arritur të identifikojmë, emrat e këtyre banoreve, lagjen rrugën, apo banesën ku kanë jetuar. Por puna jonë hulumtuese po vazhdon në këtë drejtim dhe besojmë se së shpejti rezultatet do të duken në këtë drejtim. Vetëm pas çlirimit edhe pse për dukagjinast që e vështirë të punosh dhe

AGUSTIN KOLA, DINAMI DUKAGJINAS I TIRANËS

Agustin Pjetër Kola ka lindur më 10 maj 1959 ne Tirane dhe ka qenë një futbollist me shkëlqyer skuadrës dominuse te kapinatis shqiptare te futbollit SK Tirana (17 Nëntori i atehershem) te cilin e ka udhëhequr drejt majave me te larta te futbollit shqiptare. Ishte femije kur ai filloi në ekipin e notit që stërvitej tek Liqeni Artificial. Ende pa mbaruar filloren, lë notin, sespe fillon t'i pëlqejë cirku. Shikonte mjeshterin Telat Agolli fluturonte nëpër ëndërra. Ca nga natyra dhe ca nga lloji i këtij sporti, arriti të japë shënjat e një akrobati të talentuar Agustini i vogel kudo që të ishte binte në sy, prandaj nuk i shpëtoj dot as syrit të mësuesit të fizikuturës, Aurel Verisë, që e nxiti dhe e afroi me atë që do të bëhej dashuria e fundit dhe e vetme e tij. Nuk din nese Agusti e gjeti futbollin apo futbollin starin që duhej por ajo që dijk kjo që nje shartese merkullueshme Në natyrën e vet të besimit dhe sigurisë, pa u shoqëruar nga askush, ikën dhe testohet në provat e konkurimit për Shkollën e Mjeshtërisë. Ishte shume komode per komisionin për të dhënë vendimin vet ti vlen. Bashkë me të, në grup ishin talentet e tjerë që do bënin emër në të ardhmen. Të gjithë kujtojmë me nostalgji fidanishten e futbollit tone modern, që kishte emrin "Shkëndija"... Kur ajo e mbaroi misionin e vet, Agustin bëhet pjesë e "17 Nëntorit". Ishte viti 1979... I kujtohet kur një ditë e ftoi në zyrë edhe Zevendes Ministri Brendshme. Në këmbim të "17 Nëntorit" me "Dinamon" i afroi një të drejtë studimi për Juridik dhe një apartament banimi. Edhe njëherë nga këto ndere t'i bënin dikujt në atë kohë, do të ishte shumë. Por, për Agustin Kolën para ekipit të "Tiranës" nuk vlente asgjë! I pari që e futi në udhën e sportit, ka qenë Aurel Veria, kur ishte nxënës në shkollën 8-vjeçare "Hasan



Vogli". Ndërsa fatin për të qenë treneri i parë i tij, e ka patur Enver Rada. Zhvillohej spartakiada kombëtare e fëmijëve në Durrës. Me ekipin e "Tiranës" ishte edhe 14-vjeçari Agustin Kola Karakteri i tij impulsiv, pasioni dhe dëshira për të fituar çdo dyluftim me shokët, bëri që të binte në sy edhe në fushën e lojës... Nisur nga të gjitha këto, vendi i tij më i përshtatshëm kuptohej se ishte mbrojtja e portës. Nga sedra që kishte, bëhej copë, duke u hedhur sa në një cep në tjetrin, për të mos pësuar gol as në stërvitje. Por sikur ju zbehën pak këto vlera në takimin e parë... Ndoshta edhe jo për faj të tij, se sa të mbrojtjes, pasi kishin kaluar dhjetë minuta pëson gol... Mbyllet pjesa e parë, por edhe pushimi nuk ja riktheu qetësinë. Me fillimin e pjesës së dytë, lëvizte gjithë siklet në zonën e portës, i padurueshëm për t'ju gëzuar golit të barazimit. Nuk po i durohej... I bën shenjë një shokut të vet që të futet në portë dhe sulet drejt. S'kishte kohë të disiplinonte këtë fëmijë të "pabindur" Enveri, por i mbërthyer edhe pas rezultatit të lojës, e kaloi në heshtje këtë veprim. Nuk vonoi dhe nga teknika e përsosur e Agustin Kolës vjen

goli i barazimit. Aq ju desh atij dhe ekipit për të sulmuar pa ndërprerje, rast pas rasti deri sa shënuan golin e fitores. Nga ajo ditë nuk ju rikthe portës... Ndërsa ekipi kryeqytetas nuk la ndeshje pa fituar në gjashtë takimet e radhës. Kështu, aktivitetin e parë zyrtar Agustin Kola e nis si fitues, duke ju gëzuar titullit kampion kombëtar për bashkëmoshatarët. Nga 47 gola që shënoi ekipi i tij, 17 ishin të tij.

Pasporta sportive e Agustin Koles
- Mjeshtër i Merituar sporti
- Shkollën e Mesme të Mjeshtërisë Sportive

- Institutin e Lartë të Fiskulturës "Vojo Kushi"

- Ka luajtur me "Shkëndijën", "17 Nëntorin", dhe në Greqi me "Janina", "Egaleo" dhe "Kalkithia"

- Ka fituar 8 kampionate dhe 8 kupa Republike

- Ka shënuar 152 gola në ndeshjet e kampionatit dhe 250 në ato për Kupën e Republikës, duke mbetur një nga golashtënuesit më të mirë në historinë e klubit bardheblu.

- 15 vjet ka luajtur me ekipin përfaqësues që përbën një kohë të paarritshme nga të tjerët.

- 1978. Kampion Ballkani me ekipin "Shpresa"

Gjatë një takimi në Shkodër që e fitua na 17 Nëntori 4:1, ai përplasat me mbrojtësin Kujtim Shaba dhe thyen hundën. Gjysma e të keqes për të, sepse ishin minutat e fundit të takimit dhe për më tepër, avantazhi ishte i thellë. Por e keqja e plotë vazhdoi në ditët në vazhdim. Një javë qëndroi në rregjim shtrati në shtëpi. As bukë nuk hante, por ushqej me lëngje nëpërmjet një tubi plastik. Të paktën ishte parashikuar një muaj kohë që ai të aftësohej. Sipas mjekëve kjo, pasi ai mezi priste të dielën kur do të luanin



Agustin Kola

me "Tomorin" e Beratit. Hyri në fushën e lojës, duke i frikësuar kundërshtarët jo vetëm me maskën që kishte vënë në fytyrë, por dhe me atë gol spektakolar që shënoi me kokë. Kola do të mbahet mend nga tifozët e KF Tiranës, si një nga lojtarët më rezultativ me popullor mishërim i frymes se sakrifices partneriteti i tij në sulm ishte Arben Minga me te cilin bënë fuqinë ofensive te Tiranës një nga më të paharrueshëm të futbollit shqiptar.

Pergatiti Prele Milani

Mendime për fenomenin e gjakmarrjes

(vijon nga faqe 2)

Pas dy ditësh, i ngjuari takon rastësisht një mik dhe në mes të tjerave i tha problemin që kishte ... miku nuk i mori gjë përsipër, por i tha, nesër do shkojë në shtëpi të tij për një problem, por me këtë rast do t'i bëj edhe këtë kërkesën. Miku u kthye me një vit leje ... Mendojmë, se nuk ka nevojë për koment.

Në një gazete, të muajit tetor, shkruhej në mes të tjerave "Ministria e Arsimit, nuk mori masa për fillimin e vitit shkollor të 32000 fëmijëve të ngjuar ...". Më tej, Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar shkruan në korrespondencën me Sekretarin e OKB-se, në mes të tjerave, *janë 600 gra të ngjuara ...* Ministria e Arsimit, në një emision TV, thekson "U trishtova shume kur mora në prehër vajzën e ngjuar ..." ... Disa i përdorin fëmijët, për "luftë kundër gjakmarrjes!". Ju kane mësuar nga një poezi për gjakmarrjen, për ta recituar here pas here para kamerave. Shume e habitshme, por jo shume, sepse nëpërmjet asaj apo të tjerëve merren fonde, jetohet deri në lunds duke abuzuar me gjakun e të tjerëve.

Mendojmë, se ka ardhur koha, punës që behet për të ndal gjakmarrjen, ti themi **MJAFT!** Kjo pune të ndalet këtu, se më duket kemi mjaft problem të tjera më të rëndësishme për

tu marre dhe për tu marre me to, na dalin e na teprojnë, që zgjidhja e tyre do t'na çonte edhe në ndalimin e gjakmarrjes.

Askush nuk ka të drejtë të ligjërojë gjakmarrjen. Por, në fakt po ligjërohet, sepse po të shkosh te familja e viktimës dhe ti thuash, fale gjakun e të dashurit tende, se *kush fale është burrë, se kush fale është trim* e të tjerë e të tjera shprehje të dale boje, do të thotë, që ajo familje ka të drejtë të vrasë. Askush nuk ka të drejtë të vrasë. Kur vrasjen nuk e pranon as feja e as ligji, si është e mundur, që ne të ligjërojmë të drejtën e vrasjes?!

Si është e mundur, që ata fëmijë, që kanë mbetur jetim, nuk merret përgjegjësi nga strukturat e shtetit, për ti rritur deri sa të bëhen të afte për të jetuar, për ti rrite e të mos ju mungojë gjë, të mos e ndiejnë mungesën e babës së vrare?! Si është e mundur, që as kush nuk merret për tu kujdesur ndaj atyre pleqve, që kane mbetur pa djalë? Kjo është ajo punë sociale e domosdoshme, që e zbutë urretjen ndaj vrasësit?! Por, ne vrapojmë kush e kush të jete i pari për të ndihmuar të ngjuarit, e për çfarë, sepse kane vrare, kane lanë një palë fëmijë jetim, pa babe, kane lanë një palë prindër-pleq pa djalë, pa përkrahje ... Një qëndrim i tillë ndaj vrasësit më duket i papranueshme. Ky qen-

drim e nxite më shume njerëzit e viktimës për të marre hak, për të vrare deri në pambarim e për të lënë e për të lënë fëmijë të tjerë jetim, fëmijë në rrugë të madhe, fëmijë të tjerë në prehrin e krimin ...

Pra, ai që vret të arrestohet dhe të dënohet. Familjes së viktimës ti thuhet, se nuk ke të drejtë të marrësh gjak apo hak, sepse drejtësia do bej punën e saj dhe ty të takon vetëm ajo çka do të vendos drejtësia. Ju, me rastin e humbjes së rendë, njeriut të dashur, ju lidhet fëmijëve jetim kjo apo ajo ndihme, ju jepet bursa për studime, e të tjera e të tjera. Kjo familje, vizitohet here pas here nga strukturat kompetente.

Besojmë, se në këtë rast, strukturat e shtetit do ta ndiejnë më shume përgjegjësinë dhe do të ndikojnë më shume në parandalimin e vrasjes dhe të dhunës, se gjakmarrja është pasojë e tyre. Për rrjedhojë do të kemi më pak ngujime e më pak gjakmarrje. Sigurisht, jo sipas mendimit të një Ministri të Drejtësisë, që në vitin 2009, na tha: "Jena në demokraci dhe do të ketë edhe vrasje!". Pra sipas tij, demokracia është anarki, ndërsa në fakt demokracia është rregull, është ligj.

Ne, së shpejti do ti drejtohem Kuvendit

të Republikës së Shqipërisë, për të shfuqizuar të gjitha ligjet dhe aktet nen ligjore për luftën kundër gjakmarrjes, në veçanti shoqatat e pajtimin dhe ligji numër 9389, date 4 maj 2005, mbi krijimin e "Këshillit Koordinues për Luftën kundër Gjakmarrjes, me në krye Presidentin e Republikës". Në baze të anlizës sonë, me shfuqizimin e tyre, atëherë nuk do të kemi gjakmarrjes, nuk do të kemi mafie të gjakmarrjes dhe nuk do të abuzohet, që me gjakun e derdhur, të jetojmë, ndoshta edhe në luks ...

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", është dhe do të jete e shqetësuar për çdo dhune, për çdo vrasje. Ne do të bëjmë përpjekjet tona, që nëpërmjet veprimtarive tona, nëpërmjet gazetës, nëpërmjet librit edhe në bashkëpunim me shoqata të tjerat, në bashkëpunim me strukturat e shtetit, të influencojmë më shume për emancipimin e shoqërisë sonë, e bashkësisë sonë, me konceptim e kohës për një shoqëri të hapur, në themel të cilës janë vlerat e anti-vlerat e individit. Për këtë ftojmë intelektualët dukagjinas e jo dukagjinas, mësues e mësuese, drejtues të strukturave të shtetit, të gjithë dukagjinast e shkodranet kudo që punojnë e jetojnë të bëhen pjese e këtij mendimi dhe të punojnë pa u ndalur me përgjegjësinë tone qytetare.

Ndue Sanaj,
Kryetari i Shoqatës Atdhetare
"Dukagjini"

Gjurash - Cërnojeviçët dhe vijimësia e pranisë shqiptare në Malin e Zi

Nikollë Loka

Shtirja e shtetit serb të Stefan Nemanjës në territoret që sot përbëjnë Malin e Zi, në çerekun e fundit të shek. XII, solli aty elementë sllavë, që erdhën dhe iu shtuan grupeve të tjera sllave të kohëve të kolonizimit të parë të shekujve VI-VII. Në Diokle, krahas popullsisë shqiptare edhe atyre sllave, në disa nga qytetet e bregdetit mbijetuan dhe grupe të vogla të banorëve të romanizuar, të përmendur edhe nga historiani – perandor Konstandin Porfirogeneti në shekullin X. Për rrjedhojë, në shekullin XIV Dioklea-Genta (Zeta), veçanërisht ana e sipërme e saj, u shfaqej të huajve si një vend “me popuj e fe të ndryshme”. Gjithsesi, gjatë gjithë Mesjetës krahina e bashkësi të tëra, si Kuçi, Markajt (Markoviçët), Pastroviçët, Piprët, Gjurashët (Cërnojeviçët), etj., njihen si shqiptarë. Sipas Edit Durham: “E thëna e përsëritur shpesh sikur Mali i Zi është themeluar prej refugjatëve serbë të Kosovës, është me të vërtetë një mit, mbasi beteja e Kosovës u bë një shekull më parë dhe pikërisht më 1389. Si përfundim, malazetë janë më tepër boshnjakë, hercegovinas, shqiptarë sesa serbë prej Serbie. Gjatë periudhës së sundimit serb të Zetës ndodhi procesi i sllavizimit fetar onomastik të popullsisë shqiptare të besimit katolik dhe atij ortodoks bizantin të viseve veriore dhe verilindore, atje ku presioni i shtetit serb ishte më i fortë. Një pjesë e popullsisë shqiptare të këtyre trevave, nën presionin e dhunshëm të pushtuesve serbë, gjendej në një fazë kalimtare të asimilimit kulturor dhe fetar. Në mjaft treva, ky proces asimilimi u ndërpre në kushtet e reja që u krijuan me shkatërrimin e shtetit serb e mbërritjen e turqëve osmanë...Megjithatë, në një pjesë të territoreve në fjalë, sidomos në zona të veçanta të Gentës (Zetës), procesi i sllavizimit vazhdoi edhe më vonë, duke çuar gradualisht në asimilimin kulturor dhe etnik të bashkësive të tëra shqiptare. Në librin “Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve”, Edit Durham shkruan: “Palabardhët (Bjelopavliçët), Piperët, Kuçët, Vasojeviçët e tjerë, ku të gjithë këta popuj e troje ishin safi shqiptarë, si dhe të besimit katolik, dalëngadalë, për të shpëtuar fenë e krishterë, kishin pranuar të kthehen në ortodoksë”. Dhe diku tjetër thotë: “Rusia dhe Austria arritën njëherë nga “marrëveshjet” e tyre të shumta dhe së bashku i shpallën luftë Turqisë me 1788, duke deklaruar se qëllimi i tyre ishte ti jepnin fund sundimit të Sulltanit. Së toku ata nxitën malazetë të krijonin incidente kufitare me Turqinë. Mirëpo, me që nuk u besonte malazetëve i dërguari austriak shkruante: “**Ne mund të mbështetemi shumë më fort te besa dhe guximi i shqiptarëve katolikë të Bërdes, tek ata që janë të shumtë në numër, si Bjelopavliçët, Piperët, Kuçët, Vasojeviçët, si dhe te malësorët e Kelmendit, Hotit e tjerë, që mund të nxjerrin një forcë prej 20 mijë luftëtarë të fortë e shumë më trima se sa malazetët**”. Edhe Nicola Jorga i përmend këto fise si shqiptare. Sipas tij “në shekullin XIV-XV në Zetën e Sipërme dhe atë të Poshtme ekzistojnin disa fise të fuqishme, siç ishin Gjurash – Cërnojeviçët, Hotët, Piprët, Tuzët, Shestanët, Kuçët, Grudët, Biellopavliçët, Kastratët, Bitidosët, Krajnët, Pastroviçët, etj, të cilët konsideroheshin në mënyrë eksplicite si fise shqiptare”. Të njëjtin mendim ka dhe historiani ynë Pëllumb Xhufi.

Një pjesë e konsiderueshme e malazetëve të sotëm kundërshtojnë idenë se janë serbë dhe në vend të kësaj pretendojnë se janë një grup etnik i ndarë me origjinë të përzierë sllavo-shqiptaro-vllahë, duke theksuar rëndësinë e historisë divergjente të Malit të Zi. Kundërshtarët më të ashpër shkojnë dhe më tej, duke thënë se “malazetë nuk janë sllavë, por pasardhës të ilirëve të vjetër”,

duke e parë origjinën e tyre larg në të kaluarën.

Gjuraj – Cërnojeviçët në historinë shqiptare

Gjuraj – Cërnojeviçët ishin një fis dhe si i tillë, patën shumë familje e gjini që jetuan në mjedise të ndryshme historike dhe fetare, çfarë solli që një pjesë e tyre të mbeteshin ortodoksë, siç kishin qenë në origjinë dhe pjesa tjetër u konvertuan në katolikë. Por, meqenëse



Agjon GJURASHI-Ivan Cërnojeviç

ortodoksia në trevat veriore dhe verilindore shqiptare u monopolizua nga kisha serbe që u ngrit deri në rangun e Patriarkatit, ortodoksët shqiptarë në veri nën presionin e kishës serbe dhe të sundimtarëve serbë u sllavizuan, shpëtuan vetëm ata që u konvertuan në katolikë. Kjo është arsyeja që sot Gjurajt i kemi “sllavë” dhe shqiptarë. Burimet veneciane sugjerojnë se emri Cërnojeviç është përkthimi sllavisht i emrit shqiptar Gjuraj dhe shpesh u referohen me këtë emër. Këtë praktikë e kanë ndjekur dhe disa studiues malazetë. Njëri prej tyre thekson se “Jurashëviç nuk dëshironte t’i dorëzohej Despotit serb dhe as venedikasve. (Glasnik 14, Miklosic, f.52). Po kështu, duke folur për Arqipeshkëvinë e Tivrit, ndër të tjera, autori Gjokë Dabaj citon një burim nga “Историја Цернагора 2”, sipas të cilit “një i deleguar i Kotorrit i quan Cërnojeviçët arbërorë, për t’i dalluar prej serbëve të Bosnjës dhe prej turqëve”.

Gjuraj – Cërnojeviçët i kishin zotërimet fillestare në rrethinat e grykës së Kotorrit dhe më pas i shtrinë edhe në Gentë. Ata u angazhuan në një luftë shumëvjeçare kundër përpjekjeve të Despotatit të Rashës për pushtimin e viseve bregdetare shqiptare, që shtriheshin në veri të lumit Buna. Gjatë viteve 1451-1465, principata e Cërnojeviçëve përjetoi kulmin e lulëzimit dhe të zgjerimit të saj drejt Lindjes. Qendër politike dhe administrative e saj u bë Zhabjaku, buzë liqenit të Shkodrës. Gjuraj – Cërnojeviçët mbajtën anën e venedikasve dhe në vitin 1455 u bënë vasalë të Venedikut dhe sundues të plotfuqishëm të vendit.

Në pamundësi t’u rezistonin forcave të shumta osmane, Cërnojeviçët braktisën luginën pjellore të Zetës dhe u tërhoqën në mes të fshatrave në brendësi të maleve mbi Gjirin e Kotorrit. Këtu në një rrafshnaltë rrethuar me kodra vetëm prej guri, ndërtuan një manastir dhe themeluan Cetinën, qendrën e ardhëshme të

Mbretërisë. Prej Cetine, ata organizuan rezistencën kundër otomanëve, por përballë ushtrive të mëdha turke u detyruan të kalonin në Venedik. Me largimin e tyre, rajoni rreth Cetinës, i njohur në mbarë Ballkanin, më në fund ranë nën sundimin osman.

Parë në retrospektivë, ngjarjet kryesore të periudhës së Cërnojeviçëve: betejat kundër osmanëve, largimi prej ultësirës pjellore për në malet e egra, themelimi i një kryeqyteti të ri me metropolinë e vet ortodokse. etj, japin material të mjaftueshëm për ndërtimin e historisë së Malit të Zi.

Ka pak rëndësi që Gjuraj – Cërnojeviçët në atë periudhë ishin fisnikë lokalë dhe veçoria kryesore identitare e tyre ngjan të ketë qenë në radhë të parë ortodokse. Banorët që populluan Malet e Zeza, pavarësisht etnisë së tyre, i ndoqën nga pas dhe i njohën si princa të tyre. Vendet në të cilat u tërhoqën zetanët ishin domosdoshmërisht të pakapëshme me shkëmbinj dhe të dominuara gjërësisht nga eponomi Mali i Zi. Për katër shekuj, në vijimësi, karakteri fizik i atij mjedisi ndikoi në mënyrën e jetesës së banorëve dhe historinë politike të vendit.

Mbështetur në burime serioze historike, historiografia shqiptare i ka trajtuar Gjuraj – Cërnojeviçët si shqiptarë dhe ka pasqyruar hollësisht veprimtarinë e tyre. Kështu, kur flitet për mosmarrëveshjet midis Balshajve dhe venedikasve, në librin “Historia e Popullit Shqiptar”, botim i Akademisë së Shkencave shkruhet: “Republika e Shën Markut vazhdonte të ndiqte me mosbesim fuqizimin e zotërve shqiptarë të Gentës dhe u mundua të krijonte fshehurazi një grupim kundërshtar të Balshajve me krerët shqiptarë nga familjet Gjurashi (Cërnojeviçi), Dukagjini, Zaharia, Dushmani, Shestani, të cilët Balshajt i kishin privuar nga pushteti dhe nga privilegjet e dikurshme. (Skënder Anamali, etj. Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i parë, botim i Akademisë së Shkencave, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë 2002, f. 301). Po kështu, duke folur për luftën e dyerve të mëdha shqiptare kundër sundimit serb, po në këtë libër shkruhet: “Përballë fuqisë së papërballueshme osmane, një pjesë e fisnikëve shqiptarë ngurruan në fillim t’i rrëmbenin armët, kurse kundër pushtuesve serbë ata u ngritën të gjithë, Gjurashët në radhë të parë, zotërimet e të cilëve shtriheshin në rrethinat e Grykës së Kotorrit dhe në të gjithë Gentën, Zahariajt, Dukagjinët, Kastriotët, etj”. (Skënder Anamali, etj. Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i parë, botim i Akademisë së Shkencave, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë 2002, f.313).

Gjuraj–Cërnojeviçët dalin si familje sunduese në periudhën e Mbretërisë Serbe prej vitit 1326 deri në vitin 1362 dhe pastaj prej vitit 1403 deri në vitin 1515. Me kohë kjo familje u sllavizua. Principata e tyre në shekujt XIV-XV u shtri në malsinë midis Grykës së Kotorrit dhe qytetit bregdetar të Budvës. Personaliteti më i shquar i saj konsiderohet Stefani, i cili në vitin 1444, së bashku me djemtë Gjergjin dhe Gjonin (Ivani) morën pjesë në Lidhjen e Lezhës.

Gjuraj–Cërnojeviçët kanë bërë disa lidhje martesore me familje princërore shqiptare. Stefani u martua me Marën, vajzën e Gjon Kastriotit; Gojçini u martua me vajzën e Koja Zaharisë; Gjuraj me Nora Komnenën; Ivani me Gojславën, motrën e Gjergj Arianitit; Gjon Cërnojeviçi u martua me Vojsavën, vajzën e Skënderbeut. Marrëdhëniet e Gjuraj–Cërnojeviçëve me princat e tjerë shqiptarë duhen parë si lidhje të natyrshme që vijnë jo thjeshtë prej afërsisë gjeografike, pasi si faktor me rëndësi i këtyre lidhjeve ishte dhe përkatësia e përbashkët etnike e tyre.

NË SHKODËR, RIORGANIZOHET UNIONI I GAZETARËVE SHQIPTARË

Në Shkodër, është zhvilluar më datën 13 maj 2016, në sallën e Këshillit të Bashkisë një mbledhje e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Dega Shkodër, në kuadër të riorganizimit në shkallë vendi të kësaj organizate kombëtare gazetarësh. Ishte i pranishëm edhe kryetari i UGSH, Aleksandër Cipa si dhe anëtari i kryesisë Besim Dybeli.

Kryetari i Degës së Shkodrës së Unionit të Gazetarëve Shqiptarë Arben Lagreta, përsëriti para kolegëve dorëheqjen e tij pas 9 vjetësh drejtimi. Në vijim ai mbajti një raport të hollësishëm të aktivitetit 9-vjeçar të Degës së Shkodrës, si një ndër degët e para më cilësore dhe më aktive në vend të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, e themeluar qysh në korrik të vitit 2007. Ai u ndal konkretisht në seminarët, sesionet e informimit dhe trajnimet nga më të ndryshme që gazetarët e Shkodrës kishin përfutur jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit gjatë gjithë këtyre viteve. Po kështu Lagreta vuri në dukje hartimin në vite të deklaratave të protestave nga kjo degë dhe të publikuara në mediat lokale dhe ato qendrore nga ku vlen të përmenden rasti i bastisjes së gazetës Tema në vitin 2008 si dhe rastet e incidenteve të gazetarëve të Shkodrës më policinë e në ndonjë rast tjetër me oficerë të Ministrisë së Mbrojtjes, sidomos në vitin e fundit.

“Raste të tilla të shumta të ngjashme fatkeqësisht jo vetëm në Shkodër por në tërë vendin lidhen me gjendjen faktike të lirisë së shtypit dhe medieve në Shqipëri,



të konstatuara edhe përmes raportit periodik të organizatës prestigjioze Freedom House, vetëm pak javë më parë. Në këtë raport vendi ynë, në kuadër të indeksimit global, renditet në pozicionin e 106-të me vetëm 51 pikë. Kjo është rënia më e ndjeshme e pesë viteve të fundit dhe zbritje e theksuar në krahasimin me gjendjen e shtypit në rajonin e Evropës Juglindore.”, theksoi ky i fundit në mbyllje të fjalës së tij.

Mbledhja vijoi me fjalën e kryetarit të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë Aleksandër Çipa, i cili falënderoi parafolësin për gjestin qytetar të dorëheqjes, për kontributin e tij të gjatë si dhe për përfaqësimin dinjitoz që i bëri UGSH jo vetëm në rajonin e Shkodrës por edhe

në aktivitete ndërkombëtare. “Shkodra është një nga qytetet që determinon skenën mediatike të vendit jo vetëm nga numri i medieve që funksionojnë, jo vetëm të historisë që ka në media, të kontributit dhe investimit, por edhe për një arsye tjetër që ne e konsiderojmë si organizatë. Shkodra ka media të cilat janë në garën e tyre të inovacionit teknologjik dhe për këtë arsye ne kemi krenarinë që në Shkodër kemi një zë unitar të kolegëve të bashkuar për të qenë pjesë edhe e aktivizimit të ri qoftë protestues, qoftë reagues që është paralajmëruar se do të kemi në muajt e ardhshëm.”, u shpreh ndërmjet të tjerash Cipa në fjalën e tij.

Më tej ky i fundit u ndal në riorganizimin në shkallë vendi dhe në vitalitetin akoma më të madh që do të fitonte në vijim të rrugës së tij të gjatë mbi 10-vjeçare Unioni i Gazetarëve Shqiptarë si organizata më e madhe e gazetarëve në vend.

Në mbyllje u bë edhe procesi i votimit për kryetarin e ri të kësaj dege ku me konsensus dhe në vijim me shumicë votash rezultoi fitues gazetari sportiv Gaspër Marku.

Ndërkohë burime nga Zyra e Shtypit e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në Tiranë bëjnë të ditur se Arben Lagreta është emëruar si Koordinator Rajonal për Veriun dhe për marrëdhëniet e bashkëpunimit me gazetarët në Mal të Zi.

Arben Lagreta

9 Maji, dita e fitores mbi Nazi-fashizmin

Lufta e Dytë Botërore, kasaphana më e tmerrshme që ka përjetuar njerëzimi, u frymëzue, u përgatit dhe u financue në përmasa astronomike prej forcave ultra reacionare të ekstremit të djathtë si edhe nga Oligarkia Financiare e Supër Monopolëve planetare për likuidimin e Bashkimit Sovjetik, të Komunitetit të fitoreve të klasës punëtore e Socialdemokracia liberalo-borgjeze. Nga ky konfrontim gjigant i Dritës me Errësirën, i Lirisë me Skllavërinë, u vranë 27,2 milionë sovjetikë, 405 mijë amerikanë, 420 mijë anglezë dhe miliona patriotë e antifashistë të tjerë. Edhe populli Shqiptar si pjestar i denjë i alencës së madhe Anglo Sovjeto Amerikane i dha luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtar 28 mijë dëshmorë dhe qindra qytete e fshatra të shkatëruara etj.

Në kujtimet e tij për konfliktin ruso-gjerman gjeneralit francez Gijon shkruan: “Armata tankiste gjermane e Guderianit u versul mbi Kashirën dhe Riazanin. Armiku arriti kështu rreth 25-30 km larg Moskës; në qytet dëgjoheshin gjësimet e artilerisë, një shpërthim tankësh gjermane arriti deri në zonën periferike të tij.”

“Dëshmi e mbrojtjes heroike të Moskës është fundi legjendar i 28 ushtarëve të divizionit të 316-të, sot divizioni i 8- të i Gardës i gjeneralit Panfillov. Nën urdhërat e rreshterit Dobrobadin ky nënrepart i përbërë nga rusë, ukrainas, kazakë, kirkizë e i vendosur në një llogore pranë stacionit të Dubosekovos përballoi pa u lëkundur sulmin e 50 tankëve gjermane të mbështe-



tura nga fantaria (këmbësoria). Një ushtar i vetëm ngriti duart përballë një tanku armik. Dhe atë shokët e tij e vranë. Pas 4 orë luftimesh të përgjakshme 18 tanke u dogjen apo u shkatëruan me pushkë antitanke dhe me shishe me lëndë djegëse. I erdhi koha sulmit të fundit. Instruktori politik i kompanisë Vasili Koklov, i mbiquajtur Diev, tha këto fjalë, që do të mbeten historike: “Për të

gjithë ne arriti padyshim çasti i vdekjes. Rusia është e madhe, por nuk ekziston asnjë cep në këtë tokë për t’u tërhequr. Prapa nesh është Moska.” Gja ku i derdhur lum për liri, dita historike e fitores mbi nazifashizmin, vaditi themelet e Evropës së Bashkuar. Mbi ato themele qëndron e Ardhmja, Çdo definicion tjetër nuk i qëndron të vertetës.

Barak Obama Nobelisti me zemër të madhe. Ai vuan për një të ardhme më të mirë e të sigurtë. I pari president amerikan që do të vizitojë Japoninë. Z President, më lejoni të them, sa të vëshirë e keni! Nododheni përballë një krimi të përbindshëm e mizor i kryer para 71 viteve nga paraardhësi i juaj, president i kohës në detyrë. Atëherë Juve nuk kishit lindur. Janë disa qindra e mijëra fëmijë, pleq e plaka, gra e vajza, burra e djelm, të sëmurë dhe nxenës në shkolla e konvikta krejtësisht të pafajshëm, që vdiqen mizorisht ndërkohë të tjerët vuajtën në vite nga plagët vdekjeprurëse të dy bombave atomike amerikane të hedhura mbi kokat e tyre. Ata edhe sot apelojnë për drejtësi! Kush do ti mbrojtë? Cili Ferr mund ta strehojë shpirtin përbindësh e satan të Urdhëruesit Suprem, i cili dogji në zjarrin atomik, me firmën e vulën e tij, Hiroshimen e Nagasatin?.

A mund të sigurohet paqja pa mbyllë plagët e luftës, krimet e përbindshme ndaj njerëzimit? Shpirti i njeriut kërkon prehje. Pa falje nuk ka çarmatim bërthamor, paqë as të ardhme.

Luigj Temali



Thethi shtrihet në mesin e Alpeve, aty ku malet janë rrokë me re, rrëzë malit të Radohinës, e cila ka në radhë malet si motrat e saj të cilat duken sikur janë vënë në garë se cila do të prekë më parë qiellin. Majat e tyre janë strehë e shqiponjave të lirisë, legendave për dragonj e kulshedra, orë e zana, të cilat gjithnjë kanë frymëzuar këngëtarët popullor, përradhat, legjendat, etj.

Thethi, fshati më në veri të zonës Shalë, i ka të gjitha kushtet natyrore që favorizojnë turizmin që nga ajri i pastër, uji i kristalët dhe i freskët, pyjet e gjelbëruara, arat dhe pemët frutore, si mollë, dardhë, kumbull, etj. Përmes fshatit rrjedhë lumi në qetësinë e tij shekullore, me ujë të përherëshëm dhe te freskët.

Në Theth ka mundësi të mëdha për zhvillimin e sportit të alpinizmit, mund të zhvillohet sporti i sive, patinazhi në akull, rrugëtime dhe ngjitja malore, studime biologjike, historike, etnografike, etj.. Të gjitha këto resurse natyrore mund të shfrytëzohen nga njeriu për nevojat e tij. Ky shfrytëzim i këtyre vlerave, ka filluar që herët në drejtim të turizmit, që në fillimin e shekullit të XIX. Më vonë, aty nga çerku i fundit të shekullit të XIX, nxënësit e kolegjeve françeskane filluan të dilnin për verim në Theth.

Bukuritë natyrore, por edhe vlerat shoqërore, historike dhe etnografike tërheqën vëmendjen e dashamirësve

të tyre dhe u bë e mundur që të hapet rruga e makinës deri në qendër të fshatit Theth. Kjo ishte alfa e strukturës së zhvillimit të kohës, siç pohon tekniku Beb Malaj. Pagesa për hapjen e rrugës ishte e vogël, por dëshira për të parë këtë fshat dhe gjithë zonën me rrugë makine ishte mjaftë e madhe nga malësoret dukagjinase, prandaj edhe nuk u kursyen në këtë drejtim. Hapja e rrugës favorizoi lëvizjet e njerëzve. U ndërtuan dyqane të vogla dhe të thjeshta por që ndihmuan në gjallërimin e jetës së këtij fshati por edhe të gjithë zonës. U shtuan vizitorët, dhe pati të till nga pothuaj të gjitha vendet e Europës, të cilët ndikuan edhe në sjelljen e kulturës së tyre por edhe njohën dhe morën kulturën tonë të mirë. Të tillë studiues ishin Franc Nopça, i cili bëri studime gjeologjike, por edhe etnografike dhe historike. Njohu nga afër dhe vlerësoj formacionin e krijuar "Djelmnia e Shalës" nga Mehmet Shpendi, e tërhoqi shumë mënyra e organizimit të jetës familjare, në kushtet kur vendi ishte nën pushtimin Osman, si dhe qendrimi besnik i vlerave Illo-Arbërore. Edhe studiuesja Edit Durham ishte një dashamirëse shumë e madhe e malësorëve të këtyre anëve, e tërhoqi historia e këtyre zonave, veshjet popullore, organizimi i jetës familjare. Të dy këta studiues, por edhe shumë të tjerë që kaluan në këto zona, dhe në këtë fshat, vlerësuan shumë pozitivisht

këta malësorë dhe historinë, besimin dhe kulturën e tyre.

Pas çlirimit të vendit, zhvillimi i turizmit mori një zhvillim më të organizuar. U ngrit qendra turistike që priti e përcolli shumë e shumë vizitor për pushime dhe për studime, nga të gjitha anët e botës. Kishte edhe vështirësi që koha i paraqiste, si për të hyrë në zonë kufitare duhet të merreshin leje të posaçme, vështirësitë ekonomike, mungesa e kulturës së shërbimit, pengohej turizmi privat, pa çka se në Theth ka pasur gjithnjë familje që vinin nga qyteti apo zonat fushore dhe qëndroni me javë e muaj në shtëpitë e malësorëve thethjanë, natyrisht që pagesa për qëndrimin nuk njihej, ose ishte shumë simbolike. Me shumë konsiderohej lidhje miqësore.

Pas vitit 1990, shumë familje u larguan nga fshati, në drejtim të zonave fushore, qytete, por shumë edhe në drejtim të vendeve të huaja, për një jetë më të mirë. Kjo e dobësoj disi fuqinë e aftë për punë, pra krijoj vështirës. Me kalimin e kohës rifilloj dhe po zgjohet jeta edhe në këtë fshat. Po bëhen zgjerime dhe ndërtime që kanë përparësi turizmin, i cili sot konsiderohet më fitimprurësi në këtë fshat. Po krijohen mundësi për çdo kategori vizitorësh, me e pa makina a mjete të tjera motorike, për strehim, parkim apo kampigje për të pasionuarit për qëndrim në natyrë të lirë. Në të gjitha lagjet e

fshatit Theth punohet për shfrytëzimin e kësaj degë të rëndësishme të ekonomisë, dhe kudo mund të geshë kushte të mira për të kaluar pushime të gjata apo të shkurtëra, ditore apo edhe thjeshtë si vizitor i rastit. Kudo mund të gjendet mikpritje bujare dhe kushte të mira jetese e siguria. Po bëhen ndërtime por është mirë që të jenë parasyshë karakteristikat tradicionale e zonës, të ruhet ajo dhe të përshtatet me kushtet e kohës.

Njerëzit po e kuptojnë se kudo që punohet mund të jetohet mirë. Kjo ka rëndësi edhe për këtë fshat, por edhe për të gjithë vendin. Kanë filluar të kthehen emigrantët dhe po përpiqen që të investojnë kursimet e tyre edhe në Theth.

Zhvillimit të turizmit mund ti shërbejnë shumë mirë edhe puna artizanale nga mjeshtërit e fshatit apo zonës, qofshin femra dhe meshkuj. Punimet artizanale janë shumë të kërkuara në tregun botëror.

U përpoqa që të kujtoj dhe të them disa fjalë për turizmin dhe zhvillimin e tij në Theth, me qëllim që të mund të zhvillohet akoma më shumë, në mënyrë të qëndrueshme, që të kenë mundësi edhe brezat që vinë të gjejnë një Theth po kaq të bukur dhe të begatë.

Kam bindjen se të gjithë ata që do të vizitojnë një herë Thethin dhe Alpet, e kanë të pamundur që të shkëputem më prej tyre.

PIETËR DELIA

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

VATË MUSA

Dashamirës i Shoqatës Atdhetare Dukagjini, Shkodër